

**Permbledhje**  
**e Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis**  
**Objekti: Baxho Perpunim Qumeshti e subjektit Çelnike Pupa**



**Permbledhje**  
**e Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis**  
**Objekti: Baxho Perpunim Qumeshti e subjektit Çelnike Pupa**

## Hyrje

Subjekti Çelnike Pupa e regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit në datë 01.01.2000, me qendër në Fshatin Nizhavec, Cerrave, Pogradec, me NIPT K33707664B, paraqet kerkesen per tu paisur me leje mjedisore tipi B per aktivitetin

**Qellimi i ketij aktiviteti:** Aktiviteti ka per qellim prodhimin , perpunimin , paketimin dhe ne fund tregtimin e qumeshtit dhe nenproduktet e tije si elemente shume te rëndesishem per tregun e konsumatorit vendas. Te siguroi vlerësimin e përgjithshëm, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive qe kërkojnë te zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis;

Studimi mjedisor miratohet ne **Agjensine Kombetare te Mjedisit** Tirane, ku ky institucion i mjedisit ka si objekt:

- a) Te mbroje mjedisin.
- b) Krijimin e nje stukture urbane me orientim ekologjik.
- c) Te ruaj burimet natyrore dhe tiparet e peisazhit.
- d) Te ndertoj nje infrastrukture inxhinierike per te gjithë zonen e studiuar si element baze per mbrojtjen e mjedisit.
- e) Marrja parasysh te zonave me karakter historik dhe vecori te spikatura ambientale dhe te peisazhit, duke specifikur vendin ku do te studiojme nga planet lokale, parqe natyrore, zona te mbrojtura.
- f) Elemente qe parashikon normativa ne drejtim te vlersimit te ndikimit ne mjedis (VNM). Raporti i vlersimit te ndikimit ne mjedis (VNM) duke u bazuar ne zhvillim strategjik te Fshatit Nizhavec, Njesia Administrative Çerrave, Bashkia Pogradec ka perfshire planifikimin, reabilitimin dhe masat zbutese te ndikimit te projektit ne kete zone.

Do te paraqesim gjendjen e ndikimit te ketij studimi mbi mjedisin e zones dhe shendetin e njerezve, do te shqyrtojme faktoret pozitiv dhe negativ mjedisor, do te paraqesim skemat e rehabilitimit dhe masat zbutese dhe reduktimin e impakteve negative.

**KUADRI LIGJOR VENDOR DHE NDERKOMBETAR**  
**PERMBLEDHJE E BAZES LIGJORE PER MENAXHIMIN E**  
**MJEDISIT Baza ligjore**

Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rëndesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te përmendim.

Shqipëria është nënshkruese e një numri të madh konventash

Baza Ligjore	
Nr.10431,datë 09.06.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Nr. 10 440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Nr. 10 463, date 22.09.2011	Per menaxhimin e integruar te mbetjeve
Nr.156.dt.10.10.2013	Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 10463 dt.22.9.2011 Per menaxhimin e integruar te mbetjeve
Nr. 10 448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedis
Nr.9108 date 17.07.2003	Substancat dhe preparatet kimike
Nr.9115 datë 24.07.2003	Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura
Nr.8897 datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Nr.10 081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Nr.10006, date 23.10.2008	Per mbrojtjen e Faunes se eger
Nr.9587, datë 20.07.2006	Per mbrojtjen e biodiversitetit
Nr.7875, datë 23.11.1994	Per mbrojtjen e faunes se eger dhe gjuetine", Indryshuar me:Ligjin Nr. 9219 date 08.04.2004
Nr.9385, datë 04.05.2005	Per pyjet dhe sherbimin pyjor I ndryshuar me: - Ligjin Nr. 9791 date 23.07.2007
Nr. 8770 dt 19.04.2001	Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike i azhurnuar
Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmes
Nr.8402 datë 10.9.1998	Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimitI ndryshuar me: - Ligjin Nr.9826, datë 1.11.2007
Nr. 9385, datë 4.5.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor
Nr. 8766, date 05.04.2001	Per Mbrojtjen nga zjarri dhe per shpetimin
Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Nr. 8652, date 31.07.2000	Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore
<i>Ne parlamentin Shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:</i>	

Permbledhje jo teknike e Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis

Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventes se Aarhusit” Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit
Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos” ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC)
Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005	Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor
Vendime te Keshillit te Ministrave	
VKM Nr. 686 date 29.07.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM)
VKM Nr. 99, date 18.02.2005	Per miratimin e katalogut Shqiptar te klasifikimit te mbetjeve
VKM Nr. 575 dt.24.06.2015	Per miratimin e kerkesave per manaxhimin e mbetjeve inerte
Nr. 175 dt 19.1.2011	Strategjia kombetare per menaxh e mbetjeve
Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror
Nr.804, datë 4.11.2003	Per miratimin e listës se specieve te florës Shqiptare qe vihen ne mbrojtje
Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse
Nr.805, datë 4.12.2003	Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore
Nr.803, datë 4.12.2003	Per standartet e cilesise se ajrit
Nr.103 datë 31.03.2002	Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
Nr.435 datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë
Nr.994, datë 02.07.2008	Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimarrje për mjedisin
Udhezime dhe Rregullore	

Nr.6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre
Nr.5, datë 28.12.2007	Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore
Nr. 6, datë 27.11.2007	Miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta
Nr. 6527 dt 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis gazet dhe zhurmat I ndryshuar me: - Udhëzimin Nr.12, datë 15.6.2010

## LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

dhe marrëveshjes mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

- a. Me nënshkrimin e Marëveshjes së Stabilizim Asociimit, duhet që kuadri ligjor shqiptar të pershtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel rajonal dhe ato të BE-së dhe me poshte ilustrohen në menyre të permbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit, nepermjet nje kuadri të permbledhur të qellimeve kryesore të programeve komunitare dhe direktivave kryesore që rrjedhin nga një sektor i tillë.
- b. Raporti i VNM për projektin në fjalë, mer në konsideratë dhe mundohet të përqsë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm.
- c. **Konventa dhe Protokolle**

Protokolli i Kievit, Per vleresimin strategjik mjedisor. Ratifikuar në vitin 2005

Protokolli i Kartagjenes, Per biosigurine. Bere pale ne vitin 2005

Konventa e Stockholmit, Mbi ndotesit organike te qendrueshem.

Protokolli i Kartagjenes, Per sigurine biologjike. Ratifikuar ne vitin 2004.

Konventa e Washingtonit, Per tregetine nderkombetare te llojeve te rrezikuara te flores dhe faunes se eger. Ligji nr. 9021, date 06.03.2003.

*Konventat me te rëndësishme te ratifikuara nga pala shqiptare*

Permbledhje jo teknike e Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis

Konventa ESPOO	Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar	Ratifikuar 25.02.1991	Kërkon që palët nënshkruese të kryejnë vlerësimin e ndikimit në mjedis të disa veprimtarive në një fazë të hershme të planifikimit dhe që shtetet të njoftojnë /konsultohen me njëri tjetrin të gjitha projektet për të cilat mendohet se do kenë të kenë ndikime negative.
CBD	Konventa për Diversitetin Biologjik. Ri de Janeiro 1992	Ratifikuar 10.11.1996	Angazhohet për ruajtjen e biodiversiteteve, përdorimin e pandërprerë të burimeve biologjike /ndarjen e barabartë të përfitimeve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjenetike.
Konventa e Bernës	Konventa për mbrojtjen e florës dhe faunës së egër / mjedisit natyror në Europë.	Ratifikuar nga Ligji nr.8294, 2.03.1998	Për garantimin e ruajtjes /mbrojtjes së florës/faunës së egër dhe mjedist të tyre natyror, ritjen e bashkëpunimit m palëve kontarktuuese dhe nxjerjen e akteve regullatore për shfrytëzimin e specieve (dhe shtegtare)
Konventa e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s	Konventa e për mbrojtjen e Kulturës Botërore/ Trashëgimisë Natyrore.	Ratifikuar 10. 07.1989	Ka për qëllim njohjen, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore në gjithë botën. Në Shqipëri janë përcaktuar dy qendra kulturore me vlerë universale të padiskutueshme.
Konventa e Aarhus-it	Konventa për të drejtën për Informim, pjesëmarrje në vendimarrje, dhe të Drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës për probleme të Mjedisit.	Ratifikuar Ligji nr.8672. 10. 07.1989	Garanton të drejtat e publikut për pjesëmarrje në procese Vendim marrjeje të qeverisë për çështje që lidhen me mjedisin lokal, kombëtar, ndërkufitar si dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për sa më sipër. Kërkon më shumë bashkëveprim midis publikut dhe autoriteteve / enteve publike.
Konventa e Montrealit	Protokoli i për Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit.	Ratifikuar Ligji nr.8463.	Garanton mbrojtjen e e shtresës së ozonit nëpërmjet zvogëlimit të shkallëzuar të substancave që shkaktajnë hollimin e saj
Konventa e	Konventa e vitit 1992. Për Përgjegjësinë Civile për dëmet nga ndotja me karburant	Ratifikuar Ligji nr.9293. 21.10.2004	Garanton mbrojtjen e mjedisit dhe siguimin e popullatës nëpërmjet kuadrit ligjor që mbulon me përgjegjësi entet publike dhe private.

*Parimet kryesore për mbrojtjen e mjedisit*

Referimi themelor juridik i Bashkimit European eshte themeluar nga "Traktati qe krijon kushtetuten per Europen" qe dikton parimet themelore te Komuniteti European. Ne kuader te mbrojtjes se mjedisit "Traktati" parashtron arrijten e disa parimeve qe sillet si me poshte ne menyre te integruar;

1. Politikat e BE ne fushen mjedisore kontribuojne ne arrijten e objektivave te meposhtem:
  - a. ruajtja, mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se mjedisit;
  - b. mbrojtja e shendetit njerezor;
  - c. perdorim te shkathet dhe racional te burimeve natyrore;
  - d. promovim ne planin nderkombetar te masave per zgjidhjen e problemeve te mjedisit ne nivel rajonal dhe boteror
2. Politika e BE ne fushen mjedisore synon ne nje nivel te larte kujdesi, duke patur parasysh diversitetin e situatave ne rajone te ndryshme te Bashkimit European.
3. Per te nxitur politiken ne fushen e mjedisit duhet te kihet parasysh:
  - a. te dhena shkencore dhe teknike ne dispozicion;
  - b. kushtet e mjedisit ne rajone te ndryshme te BE;
  - c. avantazhet dhe perfitimet, qe mund te rrjedhin nga veprimi ose mungesa e aksionit;
  - d. nga zhvillimi social-ekonomik i BE ne teresine e tij dhe ne zhvillimin e ekuilibruar te rajoneve te vecanta.

*Parimet e mbështetura ne Kreun II te ligjit nr.10431, date 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";* □ parimi i zhvillimit te qëndrueshëm

- parimi i kujdesit
- parimi i parandalimit
- parimi "ndotësi paguan"
- parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar
- parimi i përgjegjësisë ligjore
- parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte
- parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale
- parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore □ parimi i transparencës ne vendimmarrjen mjedisore

**"Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm"** - Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

**"Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake"** - Masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis.

**"Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore"** - Mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfutuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve. Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin marrjen e masave dhe kryerjen e veprimtarive për mbrojtjen e burimeve natyrore.

**"Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit"** - Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren:

- a) për të zëvendësuar ndërhyrjet që mund të sjellin efekte të dëmshme mbi mjedisin me ndërhyrje të tjera që paraqesin një rrezik apo kërcënim më të vogël apo kompensojnë efektet e dëmshme të pashmangshme;
- b) për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira mjedisore, përdorimin e produkteve, të pajisjeve e të aparaturave, si dhe për zbatimin e proceseve të prodhimit, që janë më pak të dëmshme apo të padëmshme për mjedisin.

**"Parimi i qasjes së integruar"** - Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit, në tërësinë e tij.

Autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cenueshmërinë e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përtëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

**"Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit"** - Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm. Republika e Shqipërisë siguron bashkëpunimin dhe solidaritetin për zgjidhjen e problemeve mjedisore globale dhe ndërqeveritare përmes marrëveshjeve ndërkombëtare e shkëmbimit të informacionit mjedisor.

Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

**Parimi "Ndotësi paguan"** - Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar.

**"Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut"** - Çdo person ka të drejtë t'i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin të cilit ai i referohet, si dhe me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare".



**“Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit”** - nxitin veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit, që parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij, si dhe projekte, që ulin përdorimin e substancave të caktuara, të lëndëve të para e të energjisë, apo që e ndotin më pak mjedisin; mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre për masat vullnetare që ato mund të ndërmarrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis.

Autoritetet publike, fusha e veprimit të të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

1. Veprimtaria e Perpunimit te Qumshtit është veprimtari me interes publik.
2. Vendimmarrja në fushën e Perpunimit te Qumshtit bëhet në kushtet e transparencës, paraprihet nga këshillimet me komunitetin e zonës dhe mendimin me shkrim të njërive përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Veprimtaria në fushën e Perpunimit te Qumshtit zhvillohet duke respektuar parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes së mjedisit.
4. E drejta për hapjen e një aktiviteti te Perpunimit te Qumshtit është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës se Perpunimit te Qumshtit dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjendet Fabrike e Perpunimit te Qumshtit, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Strukturat shtetërore, që kanë në administrim/pronësi tokë, pronë publike, pjesë e zonës së lejuar kanë të drejtë të hyjnë në marrëveshje me subjektet që fitojnë një të drejtë Per krijimin e aktivitetit te perpunimit te qumshtit mbi këtë pronë publike, pa iu nënshtruar procedurave konkurruese për dhënie me qira ose emfiteozë, sipas çmimeve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
6. Për dëmtimet e shkaktuara ndaj të tretëve, nga zotëruesi i lejes per perpunimin e qumshtit, përgjegjës është ky i fundit.

Qellimi i hartimit te raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Qellimi kryesor i përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikohen ndërthurjet e mundshme të projektit me mjedisin fizik e social dhe me politikat e mbrojtjes së mjedisit për zonat ku do të zbatohet projekti. Më konkretisht, ky dokument ka për qëllim:

- Te minimizojë streset në mjedis dhe mbi njerëzit dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e shëndetit human, tokës, kontrolli i ajrit, dhe ruajtja e cilësisë së ujit.
- Te fokusojë problemet mjedisore si kyce për planifikimin e zhvillimit e veprimtarive duke promovuar kuptimin me mire të marrëdhënieve ndërmjet masave për përdorimin e tokës, objekteve ekzistuese dhe infrastruktures specifike si transporti ose menaxhimi i mbetjeve urbane dhe industriale dhe ndikimi i tyre mjedisor, social dhe ekonomik
- Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë mjedisin njerëzor, faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

- Të evidentojë pikëprerjet dhe bashkërendimin e projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit.
- Të identifikojë statusin mbrojtës të zonave ku do të zhvillohet projekti
- Të përshkruajë vlerat natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit.
- Të identifikojë ndikimet e mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.
- Të lehtësojë vendimmarrjen e organeve kompetente planifikuese dhe mjedisore për projektin.
- Te kontribuojë ne nje proces me transparent te hartimit te projektit duke perfshire publikun dhe aktoret e tjere vendimmarrës.
- Te rrise kapacitetin administrativ te njesive te qeverisjes vendore, kooperimin dhe eficencen e sistemit te planifikimit.
- Te identifikojë kufizimet, mundesite dhe resurset mjedisore te zones te cilat do te influencojne mbi menyren se si duhet te hartohen propozimet per zhvillimin e projektit.
- Te harmonizojë ndikimet dhe perfitimet, pra efektet e kombinuara te propozimeve te ndryshme per zhvillimin e veprimtarive te propozuara me veprimtarite ekzistuese dhe te projekteve dhe planeve te tjera.

Qellimi kryesor i VNM eshte te percaktojë dhe vleresojë ndikimet qe do te kete ne mjedis punishtja e Trajtimi e Perpunitimit te Qumshetit

Ky raport i VNM e pajis shoqerine me nje instrument menaxherial per te zbatuar ne kryerjen e punimeve te parashikuara, te gjitha kerkesat ndaj mjedisit per te minimizuar ndikimet mbetese ne mjedis. Ky raport paraqet nje pershkrim te projektit, gjendjen egzistuese te mjedisit dhe jep nje vleresim te ndikimit. Ne perfundim te projektit do te behet vleresimi i pajtuesmerise me Planin e Menxhimit Mjedisor (PMM) e nese do te jete e nevojshme per vleresime shtese dhe veprime te metejshme per zvogelimin e ndikimit.

Ne baze te Ligjt nr.10431 dt 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", neni 3 i tij, citojme Objektivat e mbrojtjes se mjedisit.

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Studimi dhe vleresimi i efekteve mjedisore eshte nje moment i rendesishem e ciklit te zhvillimit te nje projekti. Studimi mund te kryhet njekohesisht ose paralelisht me me procesin e planifikimit te projektit dhe prezantohet si me vete ose si pjese e studimit te beshmerise.

Hartimi dhe zhvillimi i nje projekti te qendrushem lidhet me kompleksitetin e projektit, menjanimin e streseve mjedisore te mundshme, ndjeshmerine e komponenteve mjedisore te zones ku do te zbatohet dhe masat qe do te ndermerren per mbrojtjen e mjedisit.

Vemendje te vecante do ti kushtohet projekteve qe shkaktoine efekte mjedisore negative te dukshme sic mund te jene ndertimi i impianteve industrial qe shoqerohen me emetime, veprat e infrastruktures (rruge te reja) qe shoqerohen me efekte qe eshte shume e veshtire te identifikohen, efekte qe vijne si rezultat i rritjes se aksesit ndaj burimeve si dhe projekte qe intereferojne me ekuilibrin natyror te natyres. Ne rastet e implementimeve te projekteve te ndryshme me impakte ne mjedis, aspektet me te rendesishme mjedisore qe duhen konsideruar ne zonen ku do te zhvillohet projekti jane:

- Situata aktuale mjedisore dhe evidentimi i ekosistemeve specifike
- Problemet ekzistuese mjedisore dhe gjendja e ekosistemeve te ndryshme ne rast se proejkti nuk zbatohet.
- Përshkrimi i efekteve mjedisore te shkaktuara nga projekti dhe alternativat
- Vlerësimi i stresit te përgjithshëm mjedisor ne te ardhmen
- Nderveprimi i efekteve ekologjike, ekonomike, sociale dhe kulturore
- Rekomandime per alternativa me eekte negative me te ulëta (metoda alternative, kufizimi i emetimeve, ndotjes ne pergjithesi).
- Vleresim te përgjithshëm te situatës mjedisore ne prespektiven e zhvillimit dhe funksionimit te projektit.

#### Vendodhja e Objektivit

Fshati Nizhavec, Çerrave, Pogradec

Zona kadastrale 2808 dhe keto Numer pasurie:

**1. Nr. Pasurie 207/79/7** me siperfaqe totale ndertimore 451.1m<sup>2</sup>; kufizimi V-nr. Pasurise 207/79/8; L-nr.pasurise 207/79/8; J-nr.pasurise 207/79/8 dhe P-nr.pasurise 207/79/8

Kapaciteti prodhues dhe perpunes i qumeshtit mbi 2 ton/dite

Terreni ku eshte ndertuar objekti eshte zone fushore

#### Arsyet e zgjedhjes se Aktivitetit jane:

- Prone private e familjes
- Vendi eshte i pershtateshem per kryerjen e aktivitetit ne fjale, pasi eshte larg qendrave te banuara dhe nuk paraqet shqetesime per popullsine e zones.
- Subjekti ka ndertuar zyrat, dhe objektin e aktivitetit per qellimin final qe eshte dhene nga ana e ketij projekti.
- Aktiviteti zhvillohet ne nje zone te miratuar si zone per baxho e perpunimit te Qumeshtit ku pervec objektit jane ngritur e funksionojne dhe objekte te tjera prodhimi e perpunimi e ngjashme dhe me aktivitetin qe po studjojme.

- Aktiviteti nuk krijon probleme sociale e mjedisore
- Rreth objektit, ne distance nga ai, zhvillohen aktivitete te tjera ekonomike e tregtare te te njejtit lloj.
- Objekti eshte ne afersi te qytetit te fshatit qe kane nevoja te medha punesimi
- Rruget hyrje e dalese dhe lidhja e tyre me rruget kryesore siç eshta rruga Korce Pogradec, qe plotesojne kerkesat e rregullores, te qarkullimit dhe te sjelljes ne rruge.
- Ojekti ka ne dispozicion rrugen dytesore e cila lidhet me rrugen kryesore te lartepemendur duke plotesuar kushtet teknike per levizjen e lire te mjeteve dhe ne rast avarie te futjes ne objekt te mjeteve te emergjences.

### **Te dhena mbi plan vendosjen, skema teknologjike dhe kapacitetin e prodhues te baxhos se Perpunitimit te Qumeshtit.**

Ne baxhon e Qumeshtit ndodhen keto ambjente:

1. Laboratori
2. Homogjenizatori
3. Pasterizatori
4. Sterilizatori
5. Rekombinato
6. Zona e Chip-it.
7. Zona e mbushjes
8. Paisjet e mbushjes
9. Paisja e vendosjes se tapave
10. Paisje e paketimit
11. Zona e produkteve te fresketa
12. Garderoba
13. Tualetet
14. Zyrat

#### **Dyshemeja dhe muret**

Dyshemete jane te shtruara me pllaka me ngjyre te qarte. Jane te pastrueshme dhe te lashme, kane pendenca dhe mbyllje per largimin e ujrave qe rrjedhin nga larjet e shpeshta muret jane te veshura me pllaka dhe per pjesen qe mbetet jane te lyera me ngjyre te bardhe, jo absorbent, rezistent ndaj ujit, pa gropa ose te dala, pa te çara dhe pa asnje grope qe do te mund te ishte e pershtatshme per kolonite e parazitareve.

#### **Tavani dhe dyert**

Ata jane te lyer me ngjyre te qarte, jane te suvatuat dhe jane te lashem. Siperfaqet e mbulimit jane te ndertuara duke patur parasysh rendesine e evitimit te depozitimit te mikrobeve, mykut, dhe per te reduktuar kondensimin.

Portat jane te ilustruara, jo absorbente, jo te alteruara dhe te pastrueshme lehtesisht.

#### **Dritaret dhe ventilimi**

Dritaret mbyllet ne menyre hermetike dhe ngjiten mire me murin. Ato jane ndertuar ne menyre te tille qe te evitohet akumulimin e papastertive. Kornizat e dritareve qe nuk nevojiten per ventilim jane te bllokuara. Zonat e punes jane te mirepershtatura me proceset e ndryshme te punes. Qarkullimi i ajrit sigurohet nepermjet ventilimit te mire i cili nuk lejon akumulimin e ngrohjes dhe avujve. Çdo dritare eshte e pajisur me rrjeta kundra insekteve dhe kalimit te tyre ne ambientet e punes.

### **Ndriçimi**

Ne te gjitha ambientet eshte siguruar nje ndriçim i pershtatshem. Llambat jane te pozicionuara ne menyre qe te jene te mbrojtura nga perplasjet apo thyerjet. Te gjitha pikat e ndriçimit jane te vendosura ne menyre te tille qe te ndriçojne ne menyre uniforme te gjithe ambientin pa verbuar operatoret.

### **Tualetet dhe dhomat e zhveshjes**

Banjot kane sherbime higjenike per larjen/dezinfektimin e duarve te punonjesve, uje te ftohte, uje te ngrohte, sapun likuid, kartopeceta per te thare duart dhe kosh per mbledhjen e tyre pas perdorimit. Banjot nuk jane ne komunikim direkt me lokalet e punes dhe te stokimit dhe jane te mbajtura ne kushte higjenike te pranueshme per tere ditën dhe lahen e dezinfektohen çdo dite.

Lavamanet jane te pozicionuar ne pika, neper te cilat duhet te kalojne patjeter punonjesit e ndermarrjes ne dalje nga banjot, dhe perdorimi i tyre eshte i detyrueshem gjithmone kur hyhet ne repartin e punes. Dhomat dhe dollapet e zhveshjes jane te mjaftueshem dhe jane me mure dhe me dysheme te sheshta, te suvatuara, te lashme dhe te padepertueshme nga uji. Eshte e parashikueshme, ne raport me numrin e perdoruesve te dollapeve te zhveshjes, nje numer i duhur i dollapeve per rrobat e punes dhe per rrobat civile. Eshte e ndaluar te vishen rrobat e punes jashte zones se punes apo te hyhet me rroba civile. Eshte e parashikuar qe:

- Te kete siperfaqe te caktuara qe perdoren vetem per mbajtjen e substancave te perdorura per pastrim dhe dizinfektim te struktureve dhe te impianteve, jane te rezervuar vetem per personelin specifik.
- Te kete dollape dhe sirtare vetem per depoziten e mjeteve dhe pajisjeve per pastrim dhe dizinfektim te ambienteve dhe impianteve.
- Te kete dollape te mbyllur per te vene mjete dhe pajisje per mirembajtjen e vogel te menjehershme e domosdoshme per funksionimin e makinave te prodhimit.

### **Ambienti i jashtem**

Ambienti jashte eshte i rrethuar. E gjithë siperfaqja qe rrethon strukturat e prodhimit eshte ne kushte te mira. E gjithë siperfaqja eshte e rregulluar per te minimizuar burimet e mundeshme te ndotjes nga ambienti i jashtem.

### **Skarcot e punes**

Skarcot e prodhimit (amballazhet apo mbeturinat e lendes se pare) akumulohen perkohesisht ne kontenitore brenda ambienteve ne nje vend te percaktuar dhe largohen brenda nje kohe te shkurter duke u trajtuar si plehra.

### **Pershkrimi i elementeve te prodhimit**

#### **Pershkrimi i lendeve te para.**

Menjehere pas mjeljes qumeshti vihet ne nje vend te pastër, i cili është i tillë që shmang çdo ndikim negativ mbi cilësinë e qumeshtit. Nëse qumeshti nuk grumbullohet brenda dy orëve nga mjelja, ai pak në rast të ftohet në temperaturën 8 gradë C apo më pak në rast të grumbullimeve ditore ose 6 gradë C kur

grumbullimi nuk është ditor. Kur transportohet për në qendrën e trajtimit dhe/ose përpunimit temperatura e qumështit të ftohur nuk duhet t'i kalojë 10 gradë C, nëse qumështi nuk është grumbulluar brenda dy orëve nga mjelja.

Pajisjet e mjetet që janë caktuar për të pasur kontakt me qumështin (enët, mbajtëset e qumështit, rezervuarët që përdoren për mjeljen, grumbullimin e transportin), përkatësisht, të jenë prodhuara nga material me sipërfaqe të lëmuar, i lehtë për t'u pastruar e dezinfektuar, i qëndrueshëm ndaj korrozionit dhe që nuk lëshon lëndë në qumësht në sasi të tillë që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe në përbërjen e qumështit ose në vetitë e tij organoshqisore.

#### Qumështi i lopes duhet te ketë;

1-Permbajtje yndyre jo me te vogel se 3.6 %.

2-Pike ngrirje jo me te larte se -0.521 grade C.

3-Densiteti 1.028 gr/liter te percaktuar per qumeshthin e plote, ne temperaturen 20 grade C. 4-Permbajtja e proteines jo me pak se 28gr/liter e llogaritur duke shumezuar me 6.38 permbajtjen e azotit total te qumeshhtit , shprehur ne perqindje %. 5-Permbajtja e lendes se thate, pa yndyre jo me pake se 8.5 %

6- pH 6.5 – 6.8

### **Produktet e fresketa**

#### 1) Nenproduktet e qumeshhtit

- Djathi
- Kosi
- Gjalpi
- Gjiza
- Dhalla
- Salca
- Salca me ereza
- Qumeshhti

### **I- TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT TE DJATHIT**

#### 1) Pranimi dhe përcaktimi i cilësisë së qumështit të destinuar për Djathe.

Qumështi i destinuar për djathe duhet të plotësojë disa parametra cilësorë dhe sasior.

##### *Parametrat fiziko-kimik*

- pH (6,6-6,7)
- Aciditeti (14-18°T)
- Densiteti (1.030-1.033)
- Lenda thate pa yndyre (> 8,5%)
- Pika krioskopike (-0,520 – (-0,535)

**Parametrat cilesore**

- Testi i antibiotikut (Negative).
- Testi i mastitit (Negative).
- Ngarkesa bakteriale minimale (250 mije)
- Mungesa e gjithë falsifikatoreve (Sode, NaCl, etj)

**2) Standardizimi i yndyre**

Standardizimi i yndyres ne (2,8%, 3%), qumeshti i nenshtrohet procesit te skremimit ne 60-65 °C ku behet largimi i nje pjese te yndyres ne varesi te % se yndyres ne qumesht.

**3) Trajtimi termik i qumështit**

Qumështi i destinuar për djathë depozitohet ne tanket e pasterizimit dhe i nenshtrohet procesit te pasterizimit. Pasterizimi i qumeshtit behet ne 65 ° C per 30 minuta.

**4) Inokulimi i kultures laktike YC-X16**

Qumeshti ftohet ne temperature 42-4 °C dhe i shtohet kultura laktike termofile YC-X16 në tanke para shkarkimit ne vasken e djathit dhe lihet ne perzierje per 30 minuta deri ne pH 6,2-6,3. Ka dy arsye përse kultura hidhet ne kete faze:

- Për të pasur një shpërndarje të njëtrajtshme të kultures.
- Për ti dhene kohe kultures te aktivizohet.

**5) Perdorimi i shtesave**

Kloruri i kalciumit perdoret si shtese ne raster kur eshte i nevojshem per te permiresuar procesin e koagulimit. Kripat e klorurit të kalciumit anhidrik përdoren në dozen 20g/100 l qumësht.


**6) Hedhja e majasë (fara e djathit)**

Kur temperatura e qumeshtit bie ne 39 °C, qumeshti nga tanket e pasterizimit shkarkohet ne vaska dhe hidhet Hannilasa (fare djathi).

Sasia e majasë (farës) së djathit me bazë enzime (kimozin) është deri në 30 ml farë e lëngët me fuqi 1:10000 deri ne 1:15000 për 100 l qumësht. Për të lehtësuar shpërndarjen, majaja hollohet me dyfish e sasise se ujit. Pas hedhjes së majasë, qumështi trazohet me kujdes por jo më shumë se 2-3 minuta. E rëndësishme është që qumështi te qetësohet brenda 8-10 minutave të tjerë për të shmangur turbullimin e procesit të mpiksjes dhe humbjen e kazeinës në hirrë.

**7) Prerja e masës së mpiksuar**

Koha e mpiksjes si rregull është 15-20 minuta. Para se masa e mpiksuar të pritët, kryhet një provë e thjeshtë për të përcaktuar aftësinë e veçimit të hirrës. Në sipërfaqen e qumështit të mpiksuar ngulet një thikë dhe pastaj tërhiqet me ngadalë për ta nxjerrë derisa të bëhet çarja e duhur. Pasta (masa) munde të quhet e gatshme për tu prerë sapo të duket një plasaritje ndarëse me pamje qelqi. Prerja e copëton shtruar masën e mpiksuar në kokriza me madhësi 3-15 mm. Sa më e imët të jetë prerja, aq më e ulët është përmbajtja e lagështisë në djathin kur të përfundojë i gjithë procesi.



### 8) Largimi hirrës

Sapo pasta (masa e mpiksuar) te kete arritur aciditetin dhe fortësin e duhur behet largimi i hirres nga masa e mpiksuar duke e kaluar masen e mpiksuar ne format e djathit. Ne keto te fundit eshte hedhur paraprakisht nje sasi kripe per te ndihmuar procesin e largimit te hirres.

### 9) Trajtimi i masës së mpiksuar të djathit

Pasta e mpiksuar kalohet ne forma ku behet kriposje ne te thate dhe lihet per 24 ore ne menyre qe:


Të ndihmojë largimin përfundimtarë të hirrës.

- Të krijojë teksturën.
- T'i japë trajtë djathit.
- T'i krijojë një kore djathi me periudha të gjata stazhonimi.

### 10) Stazhonimi dhe Ruajtja


Djathi pasi ka marre formen e duhur dhe eshte larguar e gjithe sasia e hirres se mbetur kalohet ne shellire me perqendrim kripe 11% dhe me pH 4,4-4,6 dhe lihet per 48 ore. Pas kesaj periudhe kohore djathi kalohet ne shellire me perqendrim 8% me aciditet (pH 4,4-4,5) dhe ruhet ne temperatura 5-10°C per nje periudh 6 mujore.

### 11) Diagrama e procesit te prodhimit






Permbledhje jo teknike e Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis



## 12) Rendimenti i prodhimit te djathit

Nga teknologjia e shtjelluar me lart per 1000 L qumesht te fresket perfitohen afersisht 154 kg djathe.

Diagram e fluksit -djathi



## II - TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT TE KOSIT

### 1) Pranimi dhe përcaktimi i cilësisë së qumështit të destinuar për kos

Qumështi i destinuar për kos duhet të plotësojë disa parametra cilësorë dhe sasior.

#### *Percaktimi i parametrave fiziko-kimi*

- pH - (6,6-6,7)
- Aciditeti (14-18 ° T)
- Densiteti (1.030-1.033)
- Lenda thate pa yndyre (> 8,5%)
- Pika krioskopike (-0,520-0,535)

#### *Parametrat cilësorë*

- Testi i antibiotikut (Negative)
- Testi i mastitit (Negative)
- Ngarkesa bakteriale minimale (250 mije)
- Mungesa e gjithë falsifikatoreve (Sode, NaCl, etj)

### 2) Standardizimi i yndyrës

Per standardizimin e yndyrës në (1,1%, 2% dhe 2,5%), qumështi i nenshtrohet procesit të skremimit në 60-65 °C gjatë të cilit bëhet largimi i një pjese të yndyrës në varesi të % së yndyrës në qumësht. Ky proces lejon që kosi të marrë një strukturë xheli me konsistencën e dëshiruar.

3) Homogjenizimi  
Qumështi i destinuar për kos dërgohet në tanket e pasterizimit dhe i nenshtrohet procesit të homogjenizimit. Homogjenizimi bëhet në 65-70°C me një presion 150-200 bar. Ky proces parandalon kremimin e yndyrës në qumësht, përmirëson shijen dhe konsistencën e produktit të gatshëm. Homogjenizimi jep një rritje të volumit të grimcave të kazeinës duke rritur butësinë e xhelit në kos gjatë koagulimit.

### 4) Trajtimi termik

Qumështi pasterizohet në 95 °C për disa sekonda. Një trajtim i tillë termik për një kohë të shkurtër nuk çon në denaturim të dukshëm të proteinave të hirrës (gjë e cila është e nevojshme për një konsistencë të mirë të kosit), prandaj përdoret një trajtim termik me temperature të lartë për një kohë të shkurter.

### 5) Inokulimi

Mbas trajtimit termik dhe përqendrimit, qumështi ftohët deri në temperaturë 42-45 °C në tanket e fermentimit dhe kryhet inokulimi me kulturë laktike termofile YC-X16 duke shtuar kulturën në tankun e fermentimit dhe lihet në perzierje për 20-30 minuta. Pas 20-30 minutave (kohe gjatë të cilës bëhet aktivizimi i kultures laktike) bëhet mbushja dhe paketimi në makineritë e mbushjes, në paketimet me sasi të perkatëse 200 g, 300g dhe 380g dhe menjëher produkti dërgohet në dhomat e inkubimit ku ndodhet procesi i fermentimit.

### 6) Fermentimi


Periudha e inkubimit zgjat 3-4 orë. Inokulimi inicion fermentimin e laktozës me hidrolizim enzimatik në galaktozë dhe glukozë. Glukoza më tej dekompozohet me disa hapa në acid laktik. Galaktoza ngelet e papërdorur deri sa ka glukozë dhe laktozë. Kjo

fazë quhet parafermentim ku s'ka ndryshime strukture. Në momentin kur kemi ulje progresive të pH-shit (<5) fillon krijimi i xhelit dhe arrihet pika izoelektrike (konfigurim elektronik i njëjtë) me pH=4.65 që quhet faza e fermentimit. Me fillimin e zhvillimit të xhelit objektivi është rritja e viskozitetit gjë e cila çon në rritjen e kapacitetit ujë-lidhës si dhe arritja e një konsistence tipike dhe një shkarkim të dëshiruar të hirrës.

Një rëndësi mbas formimit të xhelit ka mënjanimi ndikimeve mekanike si tundje të forta të cilat çojnë në shkatërrimin e strukturës së formuar. Gjatë momentit të formimit të xhelit për kos ai duhet të jetë në gjendje stacionare, për arsye se gjatë acidifikimit dhe formimit të xhelit fillon zhvillimi i aromave. 7) Ftohja


Ne pH (4,6-4,8) produkti kalon në dhomat frigoriferik ku bëhet një ftohje e shpejtë në temperatura 0-6°C, kjo temperatura duhet të arrihet brenda 1 ore në mënyrë që procesi i acidifikimit të ndërpritet.

#### 8) Diagrama e procesit të prodhimit



10) Produkti ruhet në kushte frigoriferike në temperatura 0-6°C për 30 ditë.

11. Diagram e fluksit –kosi



### III- TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT TE GJALPIT

#### 1) Pranimi dhe përcaktimi i cilësisë se qumeshtit te destinuar per Gjalp

Qumeshti i destinuar per Gjalp duhet te plotesoje disa parametra cilesore dhe sasior.

##### *Percaktimi i parametrave fiziko-kimi*

- pH- (6,6-6,7)
- Aciditeti (14-16 °T)

##### *Parametrat cilesore*

- Ngarkesa bakteriale minimale (250 mije).
- Mungesa e gjithe falsifikatoreve (Sode, NaCl, etj).

#### 2) Skremimi i lendes se pare (qumeshtit)

Lënda e parë qumeshti i nënshtrohet procesit te skremimit ne temperatura 60-65 °C nga ku merret kremi me permbajtje yndyre 40-50% i cili nepermjet linjes automatike kalohet ne tanket e pasterizimit. Ku i nenshtrohet procesit te pasterizimit.

#### 3) Trajtimi termik

Kremi pasterizohet ne 95 °C per 15 minuta. Kremi pasterizohet me qellim qe:

- Te ulët mikrofloren e përgjithshme.
- Pasterizimi ndikon në shijen dhe aromën e gjalpit.

#### 4) Ftohja

Kremi i pasterizuar shkarkohet ne ene inoksi me mbyllje hermetike dhe dergohet ne dhomat frigoriferike në temperatura të ulëta 4-6°C dhe kthehet nga gjendja e lëngët në të ngurtë. Ne kete faze kremi përfiton fortësinë dhe elasticitetin e duhur.

#### 5) Larja e gjalpit

Kremi lahet ne makinerin e larjes (tundese) se gjalpiti me uje te ftohte 4-6 °C dhe largohet e gjithe sasia e dhalles, proces nga ku merret gjalpi.

- Sasia e ujit në tundës duhet të jetë 50-60%.
- Temperatura e ujit 4-6°C.
- Uji duhet të jetë i pastër mikrobiologjikisht.


#### 6) Shtrydhja e Gjalpit

Pas larjes, gjalpi kalon ne procesin e shtrydhjes ku largohet e gjithe sasia e ujit te mbetur gjate procesit te larjes.

7) Ambalazhimi i gjalpit

Gjalpi ambalazhohet ne sasite te ndryshme perkatesisht; 125g, 200g, 500g.


8) Diagrama e procesit te prodhimit



9) Ruajtja e gjalpit

Gjalpi ruhet ne kushte frigoriferike ne temperatura 0-6°C per nje periudhe kohore 6 mujore.

Permbledhje jo teknike e Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis





## 10 . Diagram e fluksit – gjalpi

### IV- TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT TE QUMESHTIT TE PASTERIZUAR

- 1. Pranimi dhe përcaktimi i cilësisë se qumeshtit te destinuar per Qumesht te pasterizuar**  
Qumeshti i destinuar per qumesht te pasterizuar duhet te plotesoj disa parametra cilesore dhe sasior.

#### *Percaktimi i parametrave fiziko-kimike*

- ✓ pH- (6,6-6,7)
- ✓ Aciditeti 14-18 ° T
- ✓ Densiteti 1.030-1.033
- ✓ Lenda thate pa yndyre > 8,5%
- ✓ Pika krioskopike (-0,520-0,535)

#### *Parametrat cilesore*

- ✓ Testi i antibiotikut ( Negative).
- ✓ Testi i mastitit ( Negative).
- ✓ Ngarkesa bakteriale minimale( 250 mije)  Mungesa e gjithë falsifikatoreve ( Sode, NaCl etj)

- 2. Standardizimi i yndyres.**

Standardizimi i yndyres ne (0,5%, 2% dhe 2,5%), qumeshti i nenshtrohet procesit te skremimit ne 60-65 °C ku behet largimi i nje pjese te yndyres ne varesi te % se yndyres ne qumesht.

- 3. Homogjenizimi**

Qumeshti i destinuar per prodhim qumeshti te pasterizuar, *homogjenizohet në 65-70°C me një presion 150- 200 bar.* Ky proces parandalon kremimin e yndyrës në qumësht, përmirëson shijen dhe konsistencën e produktit të gatshëm.

- 4. Trajtimi termik**

Qumeshti pasterizohet ne 95 °C per 5 min.

- 5. Ftohja**

Produkti kalon ne ftohje te shpejtë ne temperatura 0-6 °C.


- 6. Mbushja**

Mbushja behet ne menyre automatike 1000 litra qumesht per 1 ore.

- 7. Paketimi dhe Magazinimi**

Produkti paketohet ne koli 6 litreshe dhe dergohet ne dhomat frigoriferike ne temp 0-6°C, ku ruhet per 7 dite.


**Diagrama e procesit te prodhimit:**



**8. Ruajtja**

Produkti ruhet ne kushte frigoriferike ne temperatura 0-6°C per 7 dite

Diagram e fluksit – qumeshti pasterilizuar



**Kapaciteti Perpunues** Kapaciteti perpunues i qumshti mbi 2 ton ne dite

## Djath Kackavall Lope Dele

**Procedura e perpunimit:** Me ardhjen e qumeshti ne fabrike nga autobotet te cilet e grumbullojn nga fermeret fillohet me marjen e analizes per te pare nese ne qumesht ka permbajtje antibiotiku edhe behet matja e pehashit (pH). Vazhdohet me shkarkimin e autoboteve te qumeshtit ku behet pastrimi fillister me filtra per ndotje te ngurta me pas me nje filter mekanik me mende ku ndalohen qelizat somatike vazhdohet me matjen e qumeshtit edhe kalon ne pastrim automatik me baktofuge ku eliminohen te gjitha papastertit qe mund te kene kaluar. Fillohet me procesin e pasterizimit te qumeshtit ku qumeshti cohet ne temperature 63 °C per nje kohe jo me pak se 30 min ose ne temperature 72 °C per nje kohe jo me pak se 15 sek edhe ftohet ne temperature 36 °C hidhet ne vaskat e mpikjes ku i shtohet majaja e djathit per te bere lidhjen, mbas nje kohe 40 min vazhdohet me prerjen e djathit ku ndahet djathi nga hirra ku prerja per djathin kackavall behet ne grimca te madhesise se nje kokrrre misri ku mbas prerjes behet pjekja e djathit kackavall ne temperature 46 °C edhe hidhet ne format plastike te rrumbullaketa ku ka nje proces ngjeshjeje me dore per pak minuta lihen ne forma per nje periudhe prej 48 oresh, me pas kalon ne kriposjen me dore deri ne momentin e shitjes se tij ku ruhet ne frigorifer ne temperature 6 °C.

**Perbersit:** Qumesht Lope Dele, Maja djathi, Kulture Djathi, Kripe

### Pershkrimi i produktit:

Ngjyra: E verdhe Struktura : Djathi esht ne forma te rrumbullaket ne paste kompakte.

**Konfeksionimi:** Me vakum ne qese plastike nga 0.15 gr deri 8 kg.

**Jetgjatesia:** minimum 60 dite, Te ruhet ne kushte frigorifrike 2 – 6 °C

**Alergjen:** LAKTOZE. Nuk permban asnje konservant.

Parametrat mikrobiologjik:

	Njesia matese	Vlera mesatare
Enterobacteriaceae	ufc/ml	Brenda normes se lejuar
E.Coli	Ufc/ml	Brenda normes se lejuar
Salmonella		Brenda normes se lejuar

Vlerat ushqyese per 100g produkt:

Parametrat	Vlerat mesatare
Vlera energjike	263 kcal/ Kj 1090
Proteine	18.0 gr
Karbohidrate	3.60 gr
Yndyra	25.0 gr



### Karta teknologjike e produktit :

#### **Dhalle Lope i fresket**

**Procedura e perpunimit:** Fillon me tundjen e kosit te lopes ne tundese ku me vone hidhet 2% kripe edhe nenprodukti i mare nga tundja edhe larja e gjalpfit lihen te tunden deri sa arrin madhesin e nje trajtshme me pas vazhdon me mbushjen e tij ne bidona palstike 0.5 L edhe etiketimin e tyre, futen ne frigorifer ne temperature 6 °C.

**Perbersit:** Kos lope edhe produkt qe del nga tundja e kremes te gjalpfit, Kripe.

#### **Pershkrimi i produktit:**

Ngjyra: E bardhe Gjendja: i lengshem. Shija: Shije kosi e kripur.

**Konfeksionimi:** Shishe plastike 0.5 L.

**Jetgjatesia:** 10

dite, Te ruhet ne-kushte frigorifrike 2 – 6 °C **Alergjen:** LAKTOZE. Nuk permban asnje konservant.

#### **Parametrat mikrobiologjik:**

	Njesia matese	Vlera mesatare
Enterobacteriaceae	ufc/ml	Brenda normes se lejuar
E.Coli	Ufc/ml	Brenda normes se lejuar
Salmonella		Brenda normes se lejuar

#### **Vlerat ushqyese per 100g produkt:**

Parametrat	Vlerat mesatare
Vlera energjike	35 kcal/kj 180
Proteine	2.9 gr
Karbohidrate	3.5 gr
Yndyra	1.8 gr



Karta teknologjike e produktit

### Gjize e Fresket Lope Dele

**Procedura e perpunimit:** Mbas perpunimit te djathit Hirra e nxjerre kalon ne repartin e gjizes ku hidhet ne vaskat e zjerjes aty behet matja e aciditeti per te kontrolluar hirren vazhdohet me zjerjen e hirres ne temperature 90 °C . I hedhim acid citric (Limantos) deri sa te shikojm qe ne siperfaqen e kazanit te zjerjes fillojn te shfaqen grimca te bardha gjize i hedhim deri sa krijohet nje shtres e bardh ne te gjith siperfaqen e kazanit e lem edhe 5 min te piqet gjiza edhe me pas vazhdohet me heqjen e saj me luge te posacme edhe hidhet ne koshka kulluese ku lihet te kulloje edhe ftohet mbas ftohjes vazhdohet me paktemin ne qese edhe futjen ne frigorifer në temperature 6 °C.

**Perbersit:** Gjize e nxjerre nga zjerja e hirres te djathit te lopes edhe deles

**Pershkrimi i produktit:** Ngjyra: E bardhe Gjendja: Strukture jo kompakte e bute e grimcuar pa kore

**Konfeksionimi:** Ne qese plastike me peshe te ndryshme nga 1 kg deri 6 kg.

**Jetgjatesia:** 10 dite, Te ruhet ne kushte frigorifrike 2 – 4 °C **Alergjen:** LAKTOZE. Nuk permban asnje konservant.

### Parametrat mikrobiologjik:

	Njesia matese	Vlera mesatare
Enterobacteriaceae	ufc/ml	Brenda normes se lejuar
E.Coli	Ufc/ml	Brenda normes se lejuar
Salmonella		Brenda normes se lejuar

### Vlerat ushqyese per 100g produkt:

Parametrat	Vlerat mesatare
Vlera energjike	195 kcal/kj 834
/ Proteine	6.9 gr
Karbohidrate	3.6 gr

Yndyra

18.1 gr



### Karta teknologjike e produktit:

#### Salce Kosi

**Procedura e perpunimit:** Me ardhjen e qumeshti ne fabrike nga autobotet te cilet e grumbullojn nga fermeret fillohet me marjen e analizes per te pare nese ne qumesht ka permbajtje antibiotiku edhe behet matja e pehashit (pH). Vazhdohet me shkarkimin e autoboteve te qumeshtit ku behet pastrami fillister me filtra per ndotjet te vogla me pas me nje filter mekanik me menge ku ndalohen qelizat somatike vazhdohet me matjen e qumeshtit edhe kalon ne pastrim automatik me baktofuge ku eliminohen te gjitha papasteritit qe mund te kene kaluar. Fillohet me procesin e pasterizimit te qumeshtit ku qumeshti cohet ne temperature 92 °C per nje kohe te shkurter edhe ftohet direkt ne temperature 46 °C me pas vazhdohet me hedhjen e kultures se kosit edhe faren e kosit ku lihet per pak minute per tu perzier e gjith sasia ne menyre te njetrajtshme vazhdohet me mbushjen e kosit kontenitore prej 200 L futen ne dhome frigoriferike ne temperature 46 °C ku lihen per nje periudhe jo me pak se 2 ore, kosin arrihsh te ngurtesohet edhe te behet kompakt, arrihet koha e maturimit te kosit kalohet ne dhome frigoriferike ne temperature 6 °C edhe me pas kalohet ne Kullimin e kosit ne napa edhe ne these kullues. Mbasi mbaron procesi I kullimit vazhdohet me paketimin e salces ne kontenitore te ndryshem palstik.

#### Perbersit: Kos Lope i Kulluar

#### Pershkrimi i produktit

Ngjyra: E bardhe

Konsistenca: Kompakt kremose edhe jo i lengshem

Shija: Pak e tharte tipike e salces natyrale

**Konfeksionimi:** Kuti plastike 450 gr edhe kova plastike 5 kg

**Jetgjatesia:** 30 dite, Te ruhet ne kushte frigorifrike 2 – 6 °C **Alergjen:** LAKTOZE. Nuk

permban asnje konservant.

#### Parametrat mikrobiologjik:

	Njesia matese	Vlera mesatare

Enterobacteriaceae	ufc/ml	Brenda normes se lejuar
E.Coli	Ufc/ml	Brenda normes se lejuar
Salmonella		Brenda normes se lejuar

Vlerat ushqyese per 100g produkt:

Parametrat	Vlerat mesatare
Vlera energjike	209 kcal/Kj 862
Proteine	3.20 gr
Karbohidrate	8.40 gr
Yndyra	15.8 gr

### Hirre Djathi

**Procedura e perpunimit:** Mbas perpunimit te djathit Hirra e nxjerre kalon ne Filtrim per te hequr grimcat e djathit te mbetura, kalon ne procesin e pasterizimit ne temperature 63 °C per nje kohe jo me pak se 30 min ose ne temperature 72 °C per nje kohe jo me pak se 15 sek edhe ftohet ne temperature 12 °C ku vazhdon me mbushjen e saj ne bidona palstike 0.5 L edhe etiketimin e tyre, futen ne frigorifer ne temperature 6 °C.

**Perbersit:** Hirrje djathi nga punimi i djathit

#### Pershkrimi i produktit:

Ngjyra: E jeshile Gjendja: i lengshem

**Konfeksionimi:** Shishe plastike 0.5 L

**Jetgjatesia:** 4 dite te ruhet ne kushte frigoriferike 2 – 6 °C **Alergjen:** LAKTOZE. Nuk

permban asnje konservant.

Parametrat mikrobiologjik:

	Njesia matese	Vlera mesatare
Enterobacteriaceae	ufc/ml	Brenda normes se lejuar
E.Coli	Ufc/ml	Brenda normes se lejuar
Salmonella		Brenda normes se lejuar

Vlerat ushqyese per 100g produkt:

Parametrat	Vlerat mesatare
Vlera energjike	27 kcal



Proteine	0.85g
Karboidrate	5.14g
Yndyra	0.36g

### **Pershkrimi i instalimeve qe bejne pjese ne projekt:**

#### **Lidhja objektit me infrastrukturen inxhinierike:**

##### **Energjia elektrike**

Furnizimi me energji elektrike per objektin eshte siguruar me nje gabine 20 kw. Brenda objektit nuk kalojne linja elektrike qe jane ne vartesi te filialit elektrik te Pogradec.

##### **Furnizimi me uje**

Furnizimi me uji per objektin e ka siguruar nga sistem i UK Pogradec, njekohesisht nga ana jone eshte hapur dhe nje pus per te cilin kemi filluar procedurat e aplikimit

##### **Rrjeti telefonik**

Sipas azhonimit ne terren qe ka realizuar Albtelekom ne zonen e percaktuar ka rrjet telefonik.

##### **Kanalizimet e ujrave te zeza**

Ka nje sistem te kanalizimeve te ujrave te zeza. Si per nje nyje sanitare dhe per shkarkimet teknologjike te Fabrikes se Qumshtit. Ata derdhen neper kolektore dhe shkarkohen ne gropa septike qe eshte ne afersi te objektit.

Sheshi do te rrethohet ne kufijte e vete, te percaktuar ne planimetrine e vendosjes se baxhos.

### **Impakte dhe masat per mbrojtjen e komunitetit**

#### *Impeket e gjendeshme*

Ne fshatin Nizhavec dominojne ndertimet pas viteve '90. Impakte e gjendeshme te cilat jane shqetuaese per komunitetin jane:

- ✓ Cilesia e ajrit
- ✓ Prezence e larte e zhurmave
- ✓ Gjendja e rrugëve te brendeshme

- ✓ Mungese e nje sistemi te mirefillte te menaxhimit te mbetjeve (si psh seleksionimi i mbetjeve qe ne origjine).
- ✓ Tipologjia e ndërtimeve dhe zbatimi i distancave te banesave nga njëra tjetra.

#### **Pasojat ne komunitet:**

- ✓ Ne shume raste krijimi i problemeve ne shëndet per shkak te gazeve te emetuara ne karbuarantete automjetve qe lëvizin dendur ne rrugicat e zones duke krijuar probleme ne rrugët e frymëmarrjes, mushkëritë e te tjera ne varësi te imunitetit te personave.
- ✓ Zhurmat dëmtojnë sitemin e dëgjimit dhe rrisin nivelin e stresit.
- ✓ Rruget e brendeshme ne nivel jo te kenaqeshem krijojnë trafik, per pasoje emetim me te larte te gazeve nga djegia e karburanteve, pluhure zhurma.
- ✓ Aroma te pakendeshme nga kontejnerët sidomos ne stinën e veres
- ✓ Tipologjia e ndertimeve dhe distancat e banesave nga njëra tjetra krijon konflikete mes komunitetit, si pasoje e ndryshimit ne pamjes se tyre si dhe rritja e numrit te popullsisë ne kete zone.

*Hartimi i planit urbanistik ka per qellim formatimin e zones duke vendosur kriteret urbane dhe mjedisore, ku gjithkush qe do te jetoje në kete zone ta ndjej veten te sigurt duke ditur se cfar ndërtimesh do te behen përreth objektit te tij.*

#### *Impaktete e pritëshme*

Keto impakte hasen gjate zbatimit te planit ne terren, kryesihet këto impakte vine nga punimet ndertimore. Duke rritur mbetjet inerte (te ndertimit), zhurmat nga automjete e punës etj. Ajo qe vlen te theksohet eshte se ky impakt eshte mjaft afatshkurtër dhe per me shume eshte impakt i pritëshem. Plani i hartuar ka impakte pozitive ne komunitet pasi zbatohet ne përmirësim te jetës se qytetareve.

#### *Masat qe do te zbatohen per evitimin e impakteve mjedisore dhe strukturore*

Plani i hartuar eshte nje mase mjaft e fuqishme per reduktimin e impakteve ne komunitet. Masa konkrete:

- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës se rrugëve te brendeshme te kësaj nen-njesie.
- ✓ Krijimi i hapsirave dhe alternativave per parkim
- ✓ Krijimi i hapsirave te gjelbera
- ✓ Planifikimi i karakterit te ndërtimeve
- ✓ Krijimi i sistemeve me te mira per menaxhimin e mbetjeve urbane
- ✓ Vendosja e sisnjalistikave ne te gjithë rrugët dhe zbatimi i lëvizjes me nje karh te rrugicave te brendeshme

#### **Cilesia e ajrit**

Ndotja e ajrit nga kimikatet, grimcat e pluhurit ose materialet biologjike shkaktojnë shqetësime ose dëmtime tek njerëzit dhe organizmat e tjera duke ndikuar negativisht në mjedisin natyror. Burimet e ndotjes së ajrit mund të kenë origjinë natyrore ose antropogjenike. Efektet shëndetësore shkaktuar nga ndotësit e ajrit klasifikohen si ndryshime fiziologjike dhe biokimike të lehta deri ne vështirësi në frymëmarrje, nuhatje, kollitje dhe probleme kardiake e respiratore. Ndotësit kryesorë të cilët ndikojnë

në cilësinë e ajrit si NOx, SO2, CO, PM10 dhe benzeni, emetohen nga djegia e lëndës fosile për energji dhe transport. Ozoni(O3) është një ndotës sekondar i cili formohet nga oksidimi i ndotësve primarë në prani të rrezatimit diellor, i cili ndikon në ndryshimin e klimës globale. Oksidet e Squfurit dhe Azotit në prani të lagështirës së ajrit konvertohen në acide dhe depozitohen në tokë në formën e shiut acid i cili është i dëmshëm për bujqësinë dhe për mjedisin në përgjithësi. Qeveria shqiptare u bë pjesë e KKKBNK-së në janar të vitit të 1995 dhe ratifikoi Protokollin e Kiotos në 16 dhjetor 2004 duke pranuar kështu rëndësinë e problemit të ndryshimeve klimatike dhe nevojën për të marrë masa efektive në zbatimin e pasojave të këtyre ndryshimeve

### **Burimi i emetimeve në cilësinë e ajrit**

- ✓ Emetimi i gazeve nga djegia e karburantit të automjeteve që qarkullojnë në brendësi të objektit dhe përreth tij
- ✓ Kalimi i mjeteve në çdo hapësirë të këtij objekti
- ✓ Rritja progresive e numrit të automjeteve
- ✓ Cilësia e dobët e karburantit
- ✓ Afërsia me rrugën e fshatit
- ✓ Infrastruktura e dëmtuar në rrugët e brendshme

### **Masat ruajtëse të cilësisë së ajrit**

Me zbatimin e strategjisë së hartuar paralelisht do të zbatohen masat për evitimin e impakteve në cilësinë e ajrit.

- Në ditë të nxehta spërkatje të rrugëve me ujë
- Mbjellja e sa më shumë pemëve dhe krijimi i miniparqeve
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore
- Evitimi i përdorimit të gjeneratorëve në ambjentet e hapura

### **Cilësia e ujrave**

Impakte të gjatëshme

Edhe pse në distanca të mjaftueshme për tu mos u prekur nga impaktet mjedisore kjo nuk është e mundur pasi të gjitha ujat urbane shkarkohen në rrjetin qendror të zonës.

### **Burimi i impaktit dhe niveli i impaktit**

- ✓ Rrjeti i amortizuar i sistemit të kanalizimeve rrit probabilitetin e impakteve nga aksidentet me çarje apo bllokim të tubacioneve duke krijuar përhapje të baktereve dhe aromave të pakëndeshme në zonë (ky vlerësohet impakt aksidental)
- ✓ Ujrat urban të cilët do të derdhen në kolektore
- ✓ Aroma të pakëndeshme gjatë stanes së verës përgjatë kësaj rrjedhe
- ✓ Ndryshim i faunës karakteristike lumore për ta kthyer ato faunë të pershtatshme për të jetuar në ujat e ndotura

*Impakte të pritshme*

Nga zbatimi i planit te studimit nuk ndikohet cilësia e ujrave.

Duhet te meren masa per përmirësimin e rrjetit te ujrave urbane si dhe te parashkikohen impjante per paratjartimin e ketyre ujrave para derdhjes se tyre ne kolektor

### **Zhurmat**

Impakti i gjetshem

Problemi i zhurmave ne vendin tone eshte problematike ne te gjitha zonat urbane. Burimi i emetimit te zhurmave janë:

- ✓ Levizja e larte e automjetve (zhurmat motorike, borite)
- ✓ Izolimi i objekteve le per te dëshiruar

### **Pasojat**

- ✓ Prezenca e zhurmave pavarsisht se eshte e vogel ne objektet e baxhos rrit nivelin e stresit tek qytetaret sidomos tek fëmijët dhe moshat e treta.
- ✓ Demton sistemin e dëgjimit
- ✓ Prish orët pushimit
- Impakti i priteshme dhe masat zbutëse

Impakti te clat do te vine nga **baxho** apo infrastrukturës se parashikuar ne planin e studjuar krijon emetim zhurmash ne zone.

- Masat e parashikuara per evitimin e zhurmave ne mjedis
  - ✓ Propozimi i planit per përmirësimin e izolimit ndaj zhurmave te **baxhos**
  - ✓ Zbatimi me korrektësi i grafikut te punimeve te perpunimit te qumshtit □
- Krijim i hapsiarve te gjelbera

### **Mbetjet urbane**

Impakte te gjeteshme

Vendi yne nga viti ne vit po rrit interesin per përmirësimin e sistemit te mbeldhjes dhe menaxhimit te mbetjeve urbane.

Si impakt i gjetshme ne kete nen-njesia do te cilesiojme mungesën e sistemit te seleksionimit te mbetjeve qe ne origjine, vendosjen e kotenjereve te pershteshme per kete. Duhet te theksojmë se kjo i përket injisjativave te qeverisjes qendore, sigurisht qe plani jone vendore mer përsipër propozimin per përmirësimin e sistemit te menaxhimit te mbetjeve.

### **Masat per përmirësimin e sitemit te menaxhimit**

Ne kete nen-njesi vendore problemi i mbetjeve nuk haset si problematik e rende pasi nje pjese dominante e komunitet kane informacion te larte per mbajtjen pastër te mjedist ku jetojone, por lind dëshira dhe nevoja qe kjo Njesi vendore te permiresoje akoma me tej kete sistem ne bashkëpunim me organet vendore.

- ✓ Vendosja e pikave ku do te vendosen kontejnerët e grumbullimit te mbetjeve
- ✓ Pergatitja e reklamave dhe fletëpalosjeve per ndërgjegjësimin e qytetareve
- ✓ Propozimi per pastrim me te shpeshte te kontejnerëve dhe larjen e tyre me te shpeshte gjate stinës se veres.

## VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

### Te pergjithshme.

Raporti i VNM dhe i Masave Zbutëse për Fazat e ndryshme të projektit si më sipër, synon fillimisht të identifikojë burimet, receptorët dhe pasojat negative dhe rreziqet e mundshme gjatë fazes së Prodhimit të qumshetit dhe nenprodukteve të tije në baxho. Pasojat dhe/ose ndikimet mund të jenë gjeofizike, biologjike, socio-ekonomike dhe cënim i shëndetit të njeriut. Rreziqet kryesore kanë të bëjnë kryesisht me operimin e baxhos së Qumshetit. Pas identifikimit të burimeve të ndikimeve dhe pasojave, do të kryet edhe vlerësimi i pasojave të tyre mbi receptorët.

*Ndikimet grupohen si më poshtë:*

- Kimike-Fizike të cilat lidhen me ndikimet mbi burimeve natyrore si edhe proceset e degradimit fizik të mjedisit.
- Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet e energjive të rinovueshme, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjallë të ndotjes së biosferës.
- Sociologjike të lidhura me komunitetin apo edhe individët e veçante, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar.
- Ekonomike-Makroekonomike të cilat marrin parasysh ndikimet e përkohshme apo të përhershme shkaktuar për shkak të realizimit të projektit.

Zona dhe indikatorët me ndjeshmëri në zonën e baxhos		
Nr	Zona dhe receptorët e ndjeshëm	Pershkrimi
Zona dhe indikatorët e ndjeshëm fizik		
1	Gjeomorfologjia	Territori përreth objektit është fushorë, pjesërisht i atakueshëm nga erozioni
Zona dhe indikatorët e ndjeshëm biologjik		
2	Habitatet ujore dhe të brigjeve	Përreth zonës së baxhos nuk ndodhet pëllgje ujimbledhës.

3	lloje te shpendeve	Pothuajse te gjitha llojet e habitateve mbeshtesin nje shumellojshmeri shpendesh. Shpendet dhe llojet e tjere faunistike jane te ndjeshem ndaj zhurmes, ndricimit dhe pranise se punetoreve. Shqetesimet e shkurreve dhe pemeve gjate operacioneve te perpunimit te qumshtit, ndertimit te rruges dhe zones se baxhos, mund te kene pak ndikim ne disa zona strehimi te shpendeve ne zonen e proiektit.
Zonat dhe receptoret e ndjeshem shoqerore		
4	Siperfaqet bujqesore	Zona e cila do te shfrytezohet per kete aktivitet eshte fushore me pak ndertime ne largesi , e pershtateshme me ushtrimin e kesaj veprimtarie pa ndikuar ne siperfaqet bujqesore.

Nr	Komponentet e Mjedisit	Indikatorret
1	Klima	Lageshtira e ajrit, rreshjet, temperaturat, erat.
2	Cilesia e ajrit	Grimcat, NO <sub>x</sub> , SO <sub>x</sub> , CO <sub>2</sub> , THC, H <sub>2</sub> S
3	Cilesia e ujit	Mbetjet e ngurta (TDS(total dissolved solid), TSS( total suspend solid), tejdukshmeria, mbetjet toksike. Hidrokarbure, permbajtja e metaleve te renda.
4	Hidrologjia	Sistemi i kullim/shkarkimit, gjendja hidrologjike, dekantimi, erozioni.
5	Hidrogjeologjia	Ujrat nentokesore dhe cilesia e tyre.
6	Toka dhe tokat pjellore	Erozioni, bujqesia, dhe turizmi.
8	Ekologjia	Biodiversiteti dhe sasia ne boten ujore dhe ne toke, flora dhe fauna.
10	Zhurmat dhe vibracioni	Zhurmat ne oret e nates, humbja e degjimit, probleme ne komunikim.
11	Ekonomiko/social	Popullesia, te ardhurat, politikat e zhvillimit, shendeti dhe sigurimi teknik.
12	Jeta e eger dhe pyjet	Zonat e mbrojtura, habitatet dhe zonat e ndjeshme.

## Efektet pozitive

Gjate aktivitetit të perpunimit të qumeshitit dhe nenprodukteve të tij do të ketë këto ndikime pozitive e konkretisht:

- Do të punesohen rreth 10 vete dhe pjestare të familjes
- Gjatë ushtrimit të aktivitetit: ujrat e bardha e të zeza, nuk do të paraqesin problem mjedisor, pasi ato do të bashkohen me magjistralin e tubacioneve të zonës, në një distancë prej 50 m.
- Gjatë ushtrimit të aktivitetit, aktiviteti i zonës, përveç funksioneve të banimit, do të ketë karakteristika zhvillimit të aktivitetëve tregëtarë, e administrative, do të ketë dhe funksione të aktivitetëve prodhuese. Në këtë rast, mund të thuhet që ndikimet negative në mjedis, janë fare të vogla.
- Gjatë ushtrimit të aktivitetit të **baxhos**, nuk do të shkaktojë ndotje të tokës sepse nuk ka shkarkime në mjedis.
- Do të ketë rreth **20 %** të sipërfaqes me gjelberim.
- Nuk do të ketë ndotje të ujërave nentokësore sepse të gjitha ujrat e zeza që do të dalin, do të shkarkohen në kolektorin e ujërave të zeza të zonës dhe prej kësaj në tubacionin kryesor që përshkon këtë zonë.
- Nuk do të krijohen ndotje të ajrit, duke qenë se, si gjatë fazës përpunuese, në zonë nuk do të zhvillohet asnjë aktivitet industrial tjetër përveç përpunimi të qumeshitit dhe nenproduktit të tij (përjashtojë trafikun e makinave) që të ketë ndikim në mjedis.
- Zona do të mbahet me po ato funksione që ka aktualisht dhe nuk do të ketë ndryshime të destinacionit të saj.
- Aktiviteti do të ndikojë në zhvillimin e zonës.
- Do të rritet numri i aktivitetëve shoqërorë mjekësorë etj.

### **Efektet negative**

Gjatë ushtrimit të aktivitetit do të ketë ndikime negative e konkretisht:

- Çlirim i gazeve në atmosferë si rezultat i punës së kaldajës por që është i paperfillshëm.
- Gjatë ushtrimit të aktivitetit do të krijohet një nivel i caktuar i zhurmave e cila nuk do të jetë shqetësim për banorët dhe kalimtarët. Këto zhurma do të krijohen si rezultat i përdorimit të makinërive të ndryshme të linjës së përpunimit të qumeshitit.
- Do të kemi një shtim të trafikut të makinave në zonë (gjatë kohës së furnizimit)
- Do të ketë mbetje të lengeta të paketuara që u kalon data e skadencës që lindi nevojë e evadimit të tyre.

### **Masat për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të Mjedisit.**

Në planin e organizimit të punës, shoqëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndikuar sa më pak në mjedisin rrethues

Masat kryesore që do të ndermeren nga subjekti, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit janë:

#### **Dyshemeja dhe muret**

Dyshemet janë të shtruar me pllaka me ngjyrë të qarte. Janë të pastrueshme dhe të lashme, kanë pendëca dhe mbyllje për largimin e ujërave që rrjedhin nga larjet e shpeshta muret janë të veshura me pllaka dhe për

pjesen qe mbetet jane te lyera me ngjyre te bardhe, jo absorbent, rezistent ndaj ujit, pa gropa ose te dala, pa te çara dhe pa asnje grope qe do te mund te ishte e pershtatshme per kolonite e parazitareve.

#### **Tavani dhe dyert**

Ata jane te lyer me ngjyre te qarte, jane te suvatuara dhe jane te lashem. Siperfaqet e mbulimit jane te ndertuara duke patur parasysh rendesine e evitimit te depozitimit te mikrobeve, mykut, dhe per te reduktuar kondensimin. Portat jane te ilustruara, jo absorbente, jo te alteruara dhe te pastrueshme lehtesisht.

#### **Dritaret dhe ventilimi**

Dritaret mbyllen ne menyre hermetike dhe ngjiten mire me murin. Ato jane ndertuar ne menyre te tille qe te evitojne akumulimin e papastertive. Kornizat e dritareve qe nuk nevojiten per ventilim jane te bllokuara. Zonat e punes jane te mirepershtatura me proceset e ndryshme te punes. Qarkullimi i ajrit sigurohet nepermjet ventilimit te mire i cili nuk lejon akumulimin e ngrohjes dhe avujve. Çdo dritare eshte e pajisur me rrjeta kundra insekteve dhe kalimit te tyre ne ambientet e punes.

#### **Ndriçimi**

Ne te gjitha ambientet eshte siguruar nje ndriçim i pershtatshem. Llambat jane te pozicionuara ne menyre qe te jene te mbrojtura nga perplasjet apo thyerjet. Te gjitha pikat e ndriçimit jane te vendosura ne menyre te tille qe te ndriçojne ne menyre uniforme te gjithe ambientin pa verbuar operatoret.

#### **Tualetet dhe dhomat e zhveshjes**

Banjot kane sherbime higjenike per larjen/dezinfektimin e duarve te punonjesve, uje te ftohte, uje te ngrohte, sapun likuid, kartopeceta per te thare duart dhe kosh per mbledhjen e tyre pas perdorimit. Banjot nuk jane ne komunikim direkt me lokalet e punes dhe te stokimit dhe jane te mbajtura ne kushte higjenike te pranueshme per tere ditën dhe lahen e dezinfektohen çdo dite.

Lavamanet jane te pozicionuar ne pika, neper te cilat duhet te kalojne patjeter punonjesit e ndermarrjes ne dalje nga banjot; dhe perdorimi i tyre eshte i detyrueshem gjithmone kur hyhet ne repartin e punes.

Dhomat dhe dollapet e zhveshjes jane te mjaftueshem dhe jane me mure dhe me dysheme te sheshta, te suvatuara, te lashme dhe te padepertueshme nga uji. Eshte e parashikueshme, ne raport me numrin e perdoruesve te dollapeve te zhveshjes, nje numer i duhur i dollapeve per rrobat e punes dhe per rrobat civile. Eshte e ndaluar te vishen rrobat e punes jashte zones se punes apo te hyhet me rroba civile.

Eshte e parashikuar qe:

- Te kete siperfaqe te caktuara qe perdoren vetem per mbajtjen e substancave te perdorura per pastrim dhe dizifektim te struktureve dhe te impianteve, jane te rezervuar vetem per personelin specifik.
- Te kete dollape dhe sirtare vetem per depoziten e mjeteve dhe pajisjeve per pastrim dhe dizifektim te ambienteve dhe impianteve.
- Te kete dollape te mbyllur per te vene mjete dhe pajisje per mirembajtjen e vogel te menjehershme e domosdoshme per funksionimin e makinave te prodhimit.

#### **Ambienti i jashtem**

Ambienti jashte eshte i rrethuar. E gjithë siperfaqja qe rrethon strukturat e prodhimit eshte ne kushte te mira. E gjithë siperfaqja eshte e rregulluar per te minimizuar burimet e mundeshme te ndotjes nga ambienti i jashtem.

#### **Skarcot e punes**

Skarcot e prodhimit (ambalazhet apo mbeturinat e lendes se pare) akumulohen perkohesisht ne kontenitore brenda ambienteve ne nje vend te percaktuar dhe largohen brenda nje kohe te shkurter duke u trajtuar si plehra.

#### **Qarkullimi i produkteve**

Lendet e para pranohen ne nje zone te mbrojtur nga shiu dhe inspektohen menjehere dhe magazinohen ne baze te tipologjise se tyre. Te gjitha proceset realizohen sipas nje sensi "ec perpara" per te evituar rrezikun e ndotjes se kryqezuar te produkteve.



## Qarkullimi dhe kushtet e pergjithshme higjenike per personelin

Personeli ka veshje te pershtatshme e te pastra, floket mbahen te kapur e komplet te mbuluar. Ky operacion behet ne dhomat e veshjes/zhveshjes.

Ata nuk largohen nga vendi i tyre i punes deri ne fund te orarit me perjashtim kur shkojne ne banje.

Ndalohet pirja e duhanit, te ngrerit e te piset ne repartet e punes dhe ne ate te ruajtjes ose magazinimit te produkteve

### Identifikimi i rrisqeve

#### Rreziqe te lidhura me produktin

Kur identifikohen rreziqet kihen parasysh publikimet dhe dokumentacionet shkencore te lidhura me produktin edhe ne vendet ku mendohet te eksportohet i njejti produkt. Produktet e pergatitura vijne nga kombinimi i perberesve dhe si rrjedhim rreziqet mikrobiologjike mund te jene te shumta dhe ne ngarkese te faktoreve patogjene.

## 1) RREZIQE MIKROBIOLOGJIKE

- a) Bakteret-patogjenet vegetative qe shqetesojne produktet e industris se perpunimit te qumeshtit jane; Salmonella spp. L.monocytogenas, enterohemorrhagic E.coli dhe Campylobacter jejuni, C.botulinum dhe B.cereus.

Keto patogjene qe ndodhen ne qumesht kane potencialin per te shkaktuar semundje te renda si tek organizmat e reja ,te vjetra apo edhe tek individe me imunitet te larte. Ndersa patogjenet enterike jane shkakteret kryesore te shfaqjes se semundjes qe lindin nga konsumimi i produkteve te qumeshtit. Ne rastet e mikroorganizmave qe prodhojne spore apo toksina mund te behen potencialisht te rrezikshme per shendetin e konsumatorit.

- b) Viruset -Kontaminimi nga viruset nuk vjen nga facilitetet e ambjentit , por nga higjena personale e personelit, i cili nuk punon me produktet apo materialet paketuese.

## 2) Rreziqet Kimike

- a) Substancat alergjike dhe proteinat e ndryshme mund te bien ne kontakt me produktet e qumeshtit. Ingradiante te caktuar mund te shkaktojne rrezik per shendetin e konsumatorit sic mund te jene aspatamet dhe sulfitet. Ne etiketat e produkteve finale duhet te vihet ne dukje edhe permbajtja e ketyre alergjikeve, ne menyre qe konsumatori te vihet ne dijeni per permbajtjen e tyre para konsumimit te produktit.
- b) Mbetjet nga lendet larese gjate pastrimit dhe dezinfektimit te paisjeve apo impianteve perpunuese. Perdorimi jo i sakte i perqendrimit te tyre apo instrukoioneve perkates sjell kontaminimin te produktit finale.
- c) Mbetjet kimike gjate mbareshtimit te kafsheve , perdorimi i kimikateve te ndryshme gjate fazes se rritjes dhe kujdesit te kafsheve mund te sjelle kontaminim nepermjet gjirit te kafsheve gjate procesit te mjeljes.
- d) Perdorimi i vitamines D dhe vitamines A, te cilat perdoren per te fortifikuar qumeshtin. Tejkalimi i niveleve te perdorimit te tyre kthehet ne toksik .

- e) Mykotoksinat duhet të merren në konsideratë edhe pse shfaqja e tyre në lenden e parë (qumështin e papërpunuar) është e rrallë.

### 3) Rreziqet fizike

Materiale të huaja që mund të jenë : metalet, xhamat, grimca dhe ose pjesëza plastike që mund të demtojnë

#### Analiza e masave parandaluese

subjekti përcakton masa parandaluese për të rritur garancinë mbi sigurinë e ushqimeve. Ato janë:

- Rrjetat në dritare për të ndaluar hyrjen e insekteve.
- Përdorimi i materialit të ndërtimit që lahet shpejt.
- Sipërfaqet perkatese të prodhimit të shtruara ose me pllaka për të evituar formimin e pluhurave.
- Kufizimin e hyrjes së të huajve- jo të autorizuar.
- Formimi i personelit për higjienën.
- Pastrimi dhe bonifikimi i ambjentëve dhe impianteve.

#### Vlersimi i Rrisqeve

Për një analizë të thelluar të rreziqeve është e rëndësishme të shqyrtohet mundësia e lindjes së rreziqeve, në funksion të shkallës së shprehur, kur ndodhin ngjarje të rrezikshme.

Identifikimi i përgjithshëm i rreziqeve dhe vlerësimi sasior i raportit rrezik/risk sintetizohet në tabelën e mëposhtme.

Kategoria e rrezikut tregohet në kolonën e dytë.

M - Rreziku biologjik

C - Rreziku kimik

F – Rrezik fizik

G - Shkalla e rrezikut shkon nga 1 deri në 3 (shume e rende)

P - Shkalla e probabilitetit shkon nga 1 deri në 3 (shume e rende)


GXP – Në kolonën e fundit tregohet entiteti i rrezikut në bazë të produktit, të koeficientit të rrezikut dhe të probabilitetit.

KODI	KATEGORIA	RREZIQET	SHKALLA E RENDESISE (G)	MUNDESIA (P)	GXP
H1	M, C, F	Prezenca në produkt të elementeve metalike ose mbetjeve të tjera të ngurta.	3	2	6
H2	M, F	Ndotja e produktit nga kontakti me pajisje jo të pastra higjenikisht	3	2	6
H3	M, C	Prezenca e antibiotikeve	3	2	6
H4	F	Ndotja e produktit nga përdorimi i ujit jo të pastër mikrobiologjikisht ose kimikisht.	2	1	2

H5	M	Rreziku nga mosrespektimi i temperaturave dhe kohes se duhur ne procese te ndryshme te prodhimit.	3	2	6
H6	M	Ndotja e produktit dhe metodat e magazinimit ne dhoma jo higjenike.	2	1	2
H7	M	Ndotja e produktit qe i detyrohet transportit ne mbajtes jo te duhur nen profilin e higjenes	2	1	2

### Lokalizimi i rreziqeve te seleksionuara

Me poshte percaktohen fazat e prodhimit ne te cilen mund te ndodh cdo rrezik i specifikuar me pare:



## IDENTIFIKIMI I VEPRIMEVE TE KONTROLLIT

Veprimet e kontrollit synojne te eliminojne nje rrezik ose ta reduktojne ne nivele te pranueshme. Tabela me poshte sintetizon veprimet e marra per cdo rrezik te percaktuar.

KODI	RREZIQET	VEPRIME KONTROLLI
H1	Prezenca ne produkt te elementeve metalike ose mbetjeje te tjera te ngurta	Kontroll viziv dhe instrumental i lendes se pare ne cdo furnizim.
H2	Ndotja e produktit dhe metodat e magazinimit ne dhoma jo higjenike.	Kontroll higjenik dhe monitorim i vazhdueshem i temperaturave te dhomave te magazinimit.
H3	Prezenca e antibiotikeve	Analiza laboratorike e produktit fillestar selektimi dhe kualifikimi i furnitoreve.
H4	Ndotja e produktit nga perdorimi i ujit jo te paster mikrobiologjikisht ose kimikisht.	Analizat e ujit e perditesuar per pranine e klorit dhe 1 here ne 3 muaj analize mikrobiologjike
H5	Rreziku nga mosrespektimi i temperaturave dhe kohes se duhur ne procese te ndryshme te prodhimit.	Kontrolli i herepashershem i tregueseve te temperaturave te te gjitha paisjeve.
H6	Ndotja e produktit nga kontakti me paisje jo te pastra higjenikisht	Kontroll viziv i makinave te transportit.
H7	Ndotja e produktit qe i detyrohet transportit ne mbajtes jo te duhur nen profilin e higjenes.	Kontrolli viziv i pajisjeve te transportit, karroca, pirunj.

## PERCAKTIMI I CCP

Per te gjetur CCP behen analizat e efikasitetit te veprimeve te kontrollit ne menyre qe te percaktohet se kush jane veprimet qe reduktojne rrezikun nen limitin e kriticitetit te percaktuar si vlere 2.

Kjo analize eshte bere ne menyre te vecante per cdo rrezik.

Nga analizat e efikasitetit rrjedhin CCP duke percaktuar nder rreziqet e rendesishme ato per te cilat veprimet e kontrollit te percaktuara nuk kane ulur ne shkallen e duhur parametrin GxP i percaktuar ne tabelen me siper.

CCP te gjetura jane sintetizuar ne tabelen me poshte.

<b>CCP 1</b> Pranimi i qumeshtit dhe percaktimi i cilesise se tij.	Parametrat jo te duhur fiziko-kimik. Prania e antibiotikeve, falsifikatoreve, ngarkesa mikrobiale.	Realizimi i analizave perkatese.	Parametrat fizikokimike sipas normave. Testi i antibiotikut (-) Ngarkesa mikrobiale <250 mije. Munges falsifikatoresh	Analizat laboratorike sipas instruksionit: IPRO 01-08.Rev.0	Cdo furnizim	Rregullimi i parametrave ne normat e duhura Kthim mbrapsh i qumeshtit
<b>CP PASTERIZIM</b>	Mbijetese e m.o te ndryshem patogjen	Kontrollim i parametrave	Pasterizim ne 95 C per 15 min.	Kontrolli i papametrave gjate procesit	Gjate procesit	Perseritje e procesit deri ne parametrat e percaktuar
<b>CP Skremim</b>	Ndryshim i yndyres se kerkuar	Realimi i procesit ne presionin dhe temperaturen e duhur.	% e yndyres: Sipas llojit te qumeshtit Skremim ne 50-65 C	Kontrolli i papametrave gjate procesit	Gjate procesit	Perseritje e procesit deri ne parametrat e percaktuar
<b>CCP 2 STERILIZIM</b>	Asgjesim i te gjitha m.o te mundshme	Respektimi i kohes se pershtatshme ne temperaturen e duhur	Sterilizim per	Kontrollim i parametrave	Gjate procesit	Kthim ne fazen fillestare
<b>MBUSHJE</b>	Kontaminim gjate procesit	Kontrolli i parametrave te veprimit	Nuk lejohen ndotje nga paketimi	Monitorim i paisjes	Gjate procesit	Nderepreje e procesit

### ADMINISTRIMI I SISTEMIT TE AUTOKONTROLLIT

Sistemi i autokontrollit eshte i integruar me sistemin e administrimit te kualitetit prandaj aktivitetet tipike te ketij te fundit aplikohen edhe ne sistemin e autokontrollit.

Ne veçanti persa i perket aspekteve ne vazhdim:

- Verifikimeve inspektive
  - Veprimeve korigjuese
  - Formim dhe trainim i personelit
  - Administrimi i dokumentacionit dhe i regjistrimit
- Verifikimi i sistemit**

Sistemi i autokontrollit verifikohet ne menyrat e meposhtme:

- P.HACCP ben nje monitorim te vazhdueshem te veprimeve te parashikuara ne kete manual nepermjet nje aktiviteti survejimi te personelit dhe te vendeve dhe impianteve.
- P.HACCP vlereson periodikisht rezultatet e monitorimit HACCP per te analizuar efikasitetin tij.
- P.HACCP merr nje kampion te produktit te pergatitur, per te bere analizat eventuale te kontrollit te kualitetit dhe pastertise nga ana e klientit.
- Kontrollori i ngarkuar ben te pakten nje verifikim vjetor mbi sistemin HACCP (shiko proceduren PSAK02).

### Rishqyrtimi i Planit

Plani autokontrollit rishqyrtohet ne rastet e meposhtme:

- Gjate mbledhjeve te rishqyrtimit te drejtorise, vjetore.
- Veprimi i mesiperem i rishqyrtimit ben qe te rivleresohet plani i HACCP me periodicitet vjetor.
- Çdo here qe proceset e punes modifikohen.
- Çdo here qe specifikat teknike te produktit modifikohen.

PK bashke me P.HACCP, procedon duke verifikuar planin, vlereson kriticitetin e CP-ve te ndryshme, vlereson limitet kritike te CP, efikasitetin e HACCP (duke vleresuar raportet e jokonformitetit, çertifikatat e analizave, ankesat e klienteve), vlereson modifikimet e duhura. Ne çdo rast konsiderohen informacionet qe i perkasin:  Aktiviteti i monitorimit

- Aktiviteti i verifikimit
- Jokonformitete
- Veprime korigjuese dhe parandaluese
- Verifikime inspektive te jashtme

Rishqyrtimi i bere dokumentohet ne verbalet

## PERSONELI

### Kushtet higjenike te pergjithshme

Veshja eshte e pershtatshme per te gjithë punonjesit ne sektore te caktuar. Parashikohet perdorimi i kemishave persiper veshjeve normale, perdorimi i skufjeve dhe i dorezave te gomes per personelin ne zona te rendesise se vecante.

Veshjet shperndahen nga subjekti dhe kjo per te gjithë personat dhe vizitoret qe lejohet te hyjne ne siperfaqet ky punohet. Punonjesit bejne-vete-larjen dhe higjenizimin e ambientit te punes ku jane caktuar. P.HACCP eshte pergjegjes per kontrollin dhe kushtet higjenike te personelit dhe te vizitoreve eventuale.

### Trainimi i personelit per kushtet e higjenes

Personeli qe ka kontakt me produktet ushqimore trajnohet per principet e higjenes ushqimore dhe rreziket ushqimore. Ky objektiv arrihet me anen e takimeve dhe mbledhjeve informative ne grup apo ne veçanti sipas detyrave qe duhet te kryeje.

Aktiviteti i trainimit behen nga P.HACCP apo nga persona apo ndermarrje eksperte nga jashte.

Argumentet e trajtuara sintetizohen ne verbalet e mbledhjeve.

Edhe per shperndarjen e manualit sintetik behet nje treguesh shperndarje duke shenuar ne te rishqyrimet (revizionet) e bera ne kohe.

Personeli, qe kur merret ne pune formohet dhe trajnohet mbi rregullat dhe praktikat e higjenes korrekte, dhe ne çdo rast varen kartela informuese me procedurat ne ambientet ku punohet.

## GJURMUESHMERIA

Gjetshmeria e produktit mbahet nen kontroll nga sistemi i arkivimit sistematik te dokumentave qe shoqerojne furniturat.

Ndermarrja aplikon metoden FIFO, dmth konsumon te gjithë furnituren e meparshme perpara se te perdoret furnitura e mevonshme.

Ne rast alarmi e rreziku per sigurine ushqimore, kompania eshte ne gjendje te bllokoje sasite e tjera te produktit, i cili presupozohet qe eshte shkak per rrezikun e shendetit te klienteles.

## PLEHRAT

Mbetjet e prodhuara nga proceset e punes dhe te transformimit jane te pershkruara si me poshte:

- Produkte skarco jo te perdorshme per produktin njerezor.
- Mbeshtjelles, materiale ambalazhimi dhe konfeksionimi primare dhe sekondare.
- Mbetje derivante nga selektimi i lendes se pare.
- Mbetjet e produkteve ne kontenitore te perdorur per pergatitjen e tyre, per transport dhe shperndarje.

Plehrat vihen ne thase plastike te zinj dhe hidhen ne kontenitore plastike qe largohen ne kohen sa me te shkurter te mundur nga ambjentet dhe nga sipërfaqet ku punohet.

## PROCEDURA E PASTRIMIT DHE E BONIFIKIMIT

Planifikimi i nderhyrjeve te pastrimit jane te kryera pas çdo cikli pergatitje.

Kur verifikimi i procesit te pastrimit gjen infeksione mikrobike ose thyerje te limiteve, P.HACCP ben shkurtimin e kohes nga nje pastim tek tjetri dhe eventualisht ndryshimin e produktit qe eshte perdorur per pastrim.

Nderhyrjet e pastrimit behen sipas menyrave te ndryshme ne funksion te shkalles se kujdesit te kerkuar dhe te rrezikut te mundshem per pastertine e produktit. Pastrimi i perditshem i ambjenteve behet nga personeli i brendshem.

Ne te gjitha rastet pergjegjesit e brendshem informohen per rregullat e higjenes dhe formohet nga P.HACCP ose nga specialiste te jashtem.

### Pastrimi i tankeve, linjave, receptionit, botit.

(Sipas instruksionit perkates IPRO01-09 Rev 0)

Per te patur pastrim sa me te mire dhe rezultate te kenaqshme higjenike, per pjese te ndryshme te impiantit teknologjik jane ndertuar sistemet qarkulluese te pastrimit ne vend- PNV (ChIP). Ne perputhje edhe me procedurat perkatese, eshte percaktuar edhe radha e punes. Cikli i pastrimit ne baxhon e qumeshtit perfshin fazat e meposhtme.

#### 1- Pastrimi i tankeve

- Behet shpelarja fillestare me uji te paster per 350 sekonda.
- Shkarkohet uji i pare dhe kalon soda me 2 % ne 75 grad C per 600 sekonda.
- Pas sodes behet shpelarja serish me uji per 450 sekonda.
- Shkarkohet dhe kalon acidi 1 % ne 65 grad C per 600 sekonda.
- Ne fund behet shpelarja me uji te paster per 600 sekonda.

#### 2- Pastrimi i linjave

- Behet shpelarja fillestare me uji te paster per 300 sekonda.
- Shkarkohet uji i pare dhe kalon soda me 2 % ne 75 grad C per 300 sekonda.
- Pas sodes behet shpelarja serish me uji per 300 sekonda.
- Shkarkohet dhe kalon acidi 1 % ne 65 grad C per 300 sekonda.
- Ne fund behet shpelarja me uji te paster per 300 sekonda.

#### 3- Pastrimi i cisternave (botit), receptionit dhe linjes past-yougurt



- Behet shpelarja fillestare me uji te paster per 300 sekonda.
- Shkarkohet uji i pare dhe kalon soda me 2 % ne 75 grad C per 450 sekonda.
- Pas sodes behet shpelarja serish me uji per 300 sekonda.
- Shkarkohet dhe kalon acidi 1 % ne 65 grad C per 450 sekonda.
- Ne fund behet shpelarja me uji te paster per 450 sekonda.

### Shkarkimi i ujrave te ndotur nga baxho e perpunimit

Ujrat e shkarkuara nga baxho e qumeshtit ndahen ne 3 kategori:

- 1) Ujrat ftohese- meqe si rregull eshte pa ndotes , uji ftohes shkarkohet ne tubacionet e ujrave te shiut, shkrires se bores, etj.
- 2) Ujrat e shkarkuar sanitarë – keto ujra dergohen drejtperdrejte ne vend grumbulimin e tyre dhe me pas ne vaskat e dekantimit dhe ne fund ne kanalet e ujrave te zeza.
- 3) Ujrat e shkarkuar industriale- vijne nga derdhjet e qumeshtit dhe produkteve te tij, si edhe nga pastrimi i paisjeve qe kane qene ne kontakt me produktet e qumeshtit. Ky trajtim eshte i llojt mekanik, ku me pare ujrat kalojne ne filtratet perkatese. Llumi me pas pastrohet.

### Pastrimi i tualeteve

Tualetet pastrohen 3 here ne dite. Ne fillim dhe ne fund te orarit te punes plus nje larje e ndermjetme.

Menyrat e punes:

- Heqja mekanike e mbeturinave te medha nepermjet furçave dhe fshesave.
- Hedhja e ujit dhe e produktit detergjent si dhe larja me sfungjer.
- Shplarja nepermjet ujit te paster.
- Neqoftese duhet tharja me leckë te paster ose letra nje perdorimshe.

Skeda teknike e detergjenteve te perdorur jane ne anekset e ketij manuali.

Procesi i pershkruar eshte nen pergjegjesine e nje punonjesi te trajnuar mire (PK)

### Menyrat e verifikimit te efikasitetit te pastrimit

Efikasiteti i operacionit te pastrimit verifikohet me analize mikrobiologjike te tamponave mbi siperfaqet e pastruara. Analizat behen ne te njejten kohe me operaciont e pastrimit te makinerive. Tamponet merren si ne makinerite e ndotura, ashtu edhe pas operacionit te pastrimit per te verifikuar kushtet higjenike ne kushtet normale te sherbimit.

Laboratori i jashtem pergjegjes per analizat ka edhe per detyre te vendose tamponat pas kerkeses se P.HACCP. Ky i fundit ka per detyre edhe arkivizimin e rezultateve te analizave.

Limitet maksimale te pranuar te mikroorganizmave ne pjeset qe bihen ne kontakt me ushqimin jane:

<input type="checkbox"/> Per tu nisur <input type="checkbox"/> E nisur <input type="checkbox"/> E aplikuar      Efikase po <input type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> <b>TIPI I</b>	<b>LIMITI I PRANUAR</b>
<b>MIKROORGANIZMIT</b>	
Agjentet mikrobike jo patogjen	100 UFC/10cmg
Agjentet mikrobike patogjen (psh. Salmonella, Shigela, Clostridium, etj)	0 UFC/10cmg

Ne rastet kur rezultatet e analizave nxjerrin nje prezence te madhe te mikroorganizmave P.HACCP vendos veprimet korigjuese per te risjelle vlerat brenda limiteve te pranuar.

## **PROCEDURAT E DEZINFEKTIMIT DHE TE SHFAROSJES SE MINJVE**

### **Mjete parandaluese (mjete pasive)**

Perhapja parandalohet me:

- Mjete fizike (rjeta plastike tek dritaret, rjeta metalike tek hapjet)
- Ndalimi i nxjerrjes se substancave te teperta jashte vendeve te caktuara.
- Largimi i plerave organike

### **Plani i dezinfektimit**

Lufta kunder insekteve ne fazen e pergatitjes behet edhe nepermjet çarqeve me ferromone/ insekt killerave qe perveç kapjes se insekteve sherben edhe per te monitoruar nivelin e perhapjes se tyre. Ne menyre te perditshme behet nga personeli i ngarkuar per kete qellim nje kontroll i çarqeve me ferromone per te verifikuar rezultatet. Rezultati eshte i regjistruar ne modelin M-MAH01-02.

### **Veprimet korigjuese**

Limiti maksimal i pranuar eshte 6 kapje ne dite ne te gjithe siperfaqen e zene nga vendi i prodhimit. Ne rast kapjesh jashte limitit te kerkuar, personi pergjegjes per monitorimin i komunikon P.HACCP qe mund te vendose nje nderhyrje dizinfektimi te jashtezakonshem edhe ne zonat e jashtme te nderteses.

### **Plani i shfarosjes se minjve**

Lufta kunder minjve behet me çarqe te helmatisura per hapsirat e jashtme te kuzhines ne menyre qe te mbulohet uniformisht siperfaqen qe duhet te mbrohet. Helmi i çarkut zevendesohet me nje periodicitet prej 15 ditesh, skeda teknike e helmit eshte anex i ketij manuali.

Ne ambjentet e brendshme te fabrikes, ne portat hyrese, jane vendosur ne menyre te barazlartuar çarqe minjsh te cilet funksionojne me platforme ne forme pjasteri ngjites i cili sherben per kapjen e minjve. Kjo metode perdoret per te shmangur perdorimin e helmeve ne ambjentet e brendshme te kuzhines. Pozicioni planimetrik eshte i lidhur me kete manual.

Venia e çarqeve ka parasysh rrezikun e ndotjes se produktit me helmin e perdorur, distanca nga linja e prodhimit eshte e mjaftueshme per ta ruajtur nga rreziqet e ndotjes aksidentale.

Procesi eshte i pershkruar ne monitorimin e perditeshem dhe nen pergjegjesine e nje punonjesi specialist (PD) qe duhet ti shenoje ne modelin M-MAH01-04 ne rast te kapjes se tij dhe duhet ta shenoje pozicionin e kapur ne planimetri.

### **Veprimet korigjuese**

Limiti maksimal i kapjeve eshte nje kapje ne muaj ne rast te çarqeve te vendosura jashte. Nderkohe toleranca e kapjeve te minjve brenda ambjenteve te mbuluara eshte 0. Ne rast te tejkalimit te limiteve P.HACCP vendos nje nderhyrje te jashtezakonshme per shfarosjen e minjve.

Personeli formohet dhe trajnohet per te reduktuar ne minimum cdo problematike te lidhur me sigurine ne vendin e punes, sigurine ushqimore dhe kualitetin e produktit.

Atje ku egzistojne manualet e impianteve ato jane ne dispozicion te punonjesve duke qene se jane arkivuar ne vendet e punes

**Vleresimi dhe Identifikimi i impakteve negative dhe positive ne baxhon e Perpunimit te Qumeshtit**

Lloji i ndikimit ne toke	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Humbje e tokes		X
Ndryshime topografike te terrenit		X
Prishje e tokes bujqesore		X
Ndotja e tokes nga rrjedhjet		X
Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta		X
Ndotja e tokes nga depozitimet e llumrave		X

Lloji i ndikimit ne cilesine e ajrit	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit		X
Ndotja nga hidrokarburet, plumbi dhe aerosolet		X
Ndotja nga monoksidi i karbonit dhe dioksidit te sqfurit (CO, SO <sup>2</sup> )		X

Lloji i ndikimit ne floren dhe faunen	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Shkaterrimi i rendesishem i habitateve natyrore		X
Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit		X
Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne permes zones se virgjer		X
Percarje apo izolim te habitateve te egra		X
Interference midis rruges natyrale te emigrimit te sisoneve		X

Lloji i ndikimit ne uje	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Trajtimi i ujrave te ndotur		X
Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substacave te tjera		X
Impakti sekondar ne ndotjen e ujit per tokat bujqesore, ujrat nentokesore etj.		X
Modifiki ne drenazhim e ujrave natyrale		X
Ndotja e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore nga llumrat		X

Lloji i ndikimit ne ndotjen nga zhurmat	Identifikimi I ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues te zhurmave		X
Rritja e nivelit te zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinerive		X
Rritja e nivelit te zhurmave per njerezit		X
Niveli me i larte i zhurmave per kafshet		X

Lloji i ndikimit ne perfitimin e tokes	Identifikimi I ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Shkaterrim banesash		X
Ndryshime te rendesishme ne programet per te ardhmen e perdorimit te tokes		X
Rivendosje banesash		X
Shpronesime te tokes		X

Lloji i ndikimit ne trashegimine kulturore	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo

Ndryshime apo demtime te zonave arkeologjike apo me vlere historike e kulturore		X
---	--	---

Lloji i ndikimit ne energji	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Perdorim i sasive te medha te karburantit per energji		X
Rritje te rendesishme te kerkesave per burime ekzistuese te energjise apo kerkesave per tipe te tjera te energjise		X

Lloji i ndikimit ne interesin publik (infrastruktura)	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Hapja e baxhos qumshtit do te kete apo nevojje per ndryshim ne kete fushe te interesit publik	X	
Energji elektrike		X
Sistemim i komunikacionit		X
Sistemim i kanalizimit te ujrave te zeza dhe te bardha		X
Sistemim i ujesjellesit		X
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre		X

Lloji i ndikimit ne shendetin e njerezve	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Krijimi i cfaredo rreziku apo mundesie per demtimin e shendetit te njerezve		X
Krijimi i raportit te njerezve me rreziqet e mundshme per demtimin e shendetit te tyre		X

Lloji i ndikimit ne qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit	
	Gjate Perpunimit	
	Po	Jo
Shtime te rendesishme te qarkullimit te automjeteve	X	

Pakesime te vendqendrimeve te automjeteve apo nevoja per vendqendrim te reja		X
Ndikime te rendesishme ne sistemin e komunikacionit		X
Ndryshime ne qarkullimin apo te levizjes se njerezve e mallrave		X

### POLITIKA E CILESISE DHE SIGURISE

Orientimi ne CILESINE TOTALE , ne te gjithë gamen e veprimtarise te subjektit perben nje zgjedhje strategjike dhe nje aks qendror ne politiken tone:

Cilesia ne baxho nuk kufizohet thjesht me oferten e produkteve dhe sherbimeve cilesore. Per ne , cilesi do te thote : respekti ndaj konsumatoreve, punonjesve dhe bashkepunetoreve tane , perkujdesje per mbrojtjen e ambientit dhe per zhvillimin e komuniteteve lokale, detyrim i ortakeve tane per suksesin dhe vazhdimesine fitimpruresë te kompanise sone.

Ne kete kuader, cdo punonjes dhe per cdo pike prodhimi dhe shperndarje detyrohen:

- Per prodhimin e produkteve me cilesi te larte , duke plotesuar keshtu kerkesat e konsumatoreve tane
- Ne dhenien e sherbimeve te cilesise se shkelqyer, e cila u pergjigjet kerkesave dhe nevojave te klienteve tane
- Ne sanksionimin , dokumentimin dhe ruajtjen e sistemit, i cili njeh, vlereson dhe kontrollon rrisqet qe lidhen me sigurimin e te gjitha produkteve te prodhuara.
- Ne zbatimin e legjislacionit Shqiptar per ceshtjet e sigurimit te produkteve dhe rregullave te praktikës se mire industriale.

